



Matrica e Monitorimit

mbi Mjedisin Mundësues për
Zhvillimin e Shoqërisë Civile

RAPORTI

PËR SHQIPËRINË Maj 2018 - Maj 2019



Matrica e Monitorimit

mbi Mjedisin Mundësues për
Zhvillimin e Shoqërisë Civile

RAPORTI

PËR SHQIPËRINË Maj 2018 - Maj 2019

© 2019, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate, kati 10, Ap. 71-73
Kutia Postare (PO Box) 2418/1
Tel.Faks: +355 4 2254881

@ partners@partnersalbania.org

www.partnersalbania.org



Ky botim u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe IBON International përmes CSO Partnership for Development Effectiveness (CPDE). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësia e vetme e autorëve dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se reflekton pozicionin e Bashkimit Evropian, dhe IBON International.

Ekipi i studimit

Juliana Hoxha
Klotilda Tavani
Kostandina Këruti

Grafika dhe faqosja:

Elona Kapexhiu

Tabela e Përmbajtjes

I. Përmbledhje Ekzekutive	6
Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile në Shqipëri.....	6
Gjetjet kryesore.....	9
Rekomandimet kryesore.....	10
Rreth Matricës.....	11
II. Hyrje.....	12
Rreth raportit të monitorimit.....	12
Matrica e e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile	12
III. Metodologjia	13
Përmbledhje e përqasjes metodologjike.....	13
IV. Gjetje dhe Rekomandime	14
Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive.....	14
Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të	18
Fusha 3: Marrëdhënia Shtet - OSHC	25
Referenca.....	32

I. Përmbledhje Ekzekutive

SHOQËRIA CIVILE DHE ZHVILLIMI I SHOQËRISË CIVILE NË SHQIPËRI

Garancitë themelore juridike të lirive:

Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) në Shqipëri, gëzojnë lirinë e organizimit dhe shprehjes bazuar në kuadrin ligjor aktual. Edhe pse ligji për Organizatat Jofitimprurëse nuk ndryshoi gjatë vitit 2018, ai ende ka nevojë për përmirësime përsa i përket procedurave të regjistrimit dhe ri-regjistrimit të organizatave jofitimprurëse.

Mungesa e të dhënave të unifikuara publike mbi OSHC-të vazhdon të vërë në pikëpyetje madhësinë e sektorit. Sipas informacionit zyrtar të marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë gjithsej janë regjistruar **11,426 OSHC**. Vetëm në vitin 2018, janë regjistruar **400 OSHC**, ndër të cilat **276 Shoqata**, **45 Fondacione** dhe **79 Qendra**. Sipas informacionit zyrtar të marrë nga Instituti i Statistikave (INSTAT)¹ janë **2,323 OSHC aktive**. Vetëm gjatë vitit 2018 janë regjistruar **289 OSHC** të reja. Nga i njëjti burim raportohen **8,917 punonjës** të punësuar në OSHC. Numri mesatar i të punësuarve për OSHC është **3.85 punonjës**. Punonjësit që punojnë në OSHC përfaqësojnë **0,72%** të numrit total të të punësuarve në Shqipëri.²

Referuar organizatave të ç`regjistruara, nga të dhënat zyrtare të marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë **140 OSHC** që janë shpërbërë, ose që janë në proces likuidimi dhe ç`regjistrimi, ndërsa sipas të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve **176 OSHC** janë shpërbërë. Numri i marrë nga autoritetet tatimore është pak më i lartë, pasi përfshin dhe forma të tjera tek kategoria e OSHC-ve (universitete, kompani private, etj.)

¹ Informacioni i marrë sipas kërkesës zyrtare për informacion nga Partnerët Shqipëri kundrejt INSTAT

² Kjo shifër është llogaritur bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga publikimi Tregu i Punës 2018 : <http://www.instat.gov.al/media/5575/tregu-i-punes-2018-ang-alb.pdf>

Kërkesa kryesore e raportimit për OSHC-të mbetet dorëzimi i pasqyrave vjetore financiare bazuar në Standartin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse, i cili paraqet lehtësi dhe efikasitet për OSHC-të e vogla. Ligji Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” përmban kërkesa të reja raportimi për bizneset dhe OSHC-të të cilat kanë vlerë të aseteve dhe/ ose të ardhurave mbi 30 milionë lekë (përafërsisht 240,000 Euro). Kërkesat kanë rritur barrën dhe ndërhyrjen e shtetit për këto OSHC.

Përsa i përket lirisë për tubime paqësore, është i nevojshëm përmirësimi i Ligjit Nr. 8773, datë 23.04.2001 “Për Tubimet”, i cili duhet të qartësojë “njoftimet” përkundrejt “kërkesës”/ “lejes”. Gjithashtu, ligji duhet të adresojë të drejtën për tubime spontane dhe kundër – tubime si dhe krijimin e formateve të njoftimit online për të mundësuar kryerjen e procedurës së njoftimit përmes internetit.

Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të:

Trajtimi fiskal i OSHC-ve mbetet problematik dhe paraqet një pengesë të madhe për veprimtarinë, zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e tyre.

Sipas legjislacionit në fuqi, OSHC-të mund të kryejnë veprimtari ekonomike për të gjeneruar të ardhura, në përmbushje të qëllimit të përcaktuar në statut dhe aktin e themelimit. Veprimtaria ekonomike nuk duhet të jetë aktiviteti primar i OSHC-ve (aktiviteti jo-ekonomik duhet të mbizotërojë) dhe të ardhurat vjetore nga aktiviteti ekonomik nuk duhet të kalojnë 20% të të ardhurave totale vjetore. Nëse kjo shumë tejkalon kufirin e regjistrimit të TVSh-së prej 2 milion lekësh (përafërsisht 15,000 Euro) atëherë OSHC-të, si çdo person tjetër i tatueshëm duhen të regjistrohen dhe deklarojnë TVSh-në, sipas ligjit mbi procedurat tatimore të vitit 2018.

Me plotësimin e paketës ligjore mbi ndërmarrjet sociale (NS), ka nisur zbatimi i ligjit “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”. Paketa ligjore e miratuar prezanton shumë çështje problematike, dhe meqë OSHC-të janë e vetmja formë juridike e cila mund të aplikojë për të marrë statusin e ndërmarrjes sociale, ligji dhe aktet ligjore përkatëse ndikojnë negativisht tek to. Sipas Ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”³ veprimtaria ekonomike nuk duhet të përbëjë qëllimin parësor të veprimtarisë së organizatës, ndërsa Ligji “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë” përcakton që të gjitha fitimet duhet të ri-investohen dhe pavarësisht nga paqartësia e ligjit, fitimi do të tatohet duke zbatuar të njëjtën kërkesë fiskale si biznesi privat. Këto dy çështje paraqesin mjaftueshëm arsyetim për një amendim sa më të shpejtë të Ligjit “Për Organizatat Jofitimprurëse”, duke sqaruar veprimtarinë ekonomike dhe mënyrën e trajtimit fiskal të saj.

Financimi publik për veprimtarinë e OSHC-ve është një faktor i rëndësishëm për të siguruar një shoqëri civile aktive dhe të qëndrueshme. Siç është identifikuar edhe në raportet e mëparshme të Matricës së Monitorimit, të dhënat mbi financimin publik për OSHC-të nuk janë publike dhe nuk janë të lehta për t’u aksesuar. Transparenca e shpërndarjes së fondeve publike është e ulët dhe mbetet një çështje shqetësuese për sektorin. Pavarësisht faktit që institucionet publike kanë rregulla dhe procedura të mirëpërcaktuara mbi të, informacioni i bërë publik është jo i plotë dhe jo në përputhje me Standartin e përcaktuar.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile mbetet mekanizmi kryesor në nivel kombëtar për shpërndarjen e fondeve publike tek OSHC-të, duke synuar të mbështesë zhvillimin e tyre institucional, projektet në përputhje me prioritetet e identifikuar dhe bashkëfinancim për projektet e mbështetura nga Bashkimi Evropian. Gjatë vitit 2018, Agjencia ka shpallur fituese 45 projekt propozime, ndërsa mbështetja institucionale u është ofruar 14 OSHC-ve. Thirrja për projekt propozime mbi mbështetjen institucionale nuk është bërë publike dhe mungon formati i aplikimit për këtë lloj mbështetjeje. Mbeten të paqarta kriteret mbi të cilat është bazuar vendimmarrja për mbështetjen institucionale.

³ GZ 28/2001, Ligji nr. 8788, datë 07/05/2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” [Online] <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2001/05/07/8788>

Pothuajse pas tre vitesh nga miratimi i Ligjit 45/2016 “Mbi Vullnetarizmin”⁴, aktet nënligjore që duhet të adresonin regjistrin e vullnetarëve, krijimin e skemave të financimit publik, krijimin e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave mbi aktivitetin vullnetar në vend dhe kodi etik mbi vullnetarizmin ende nuk janë hartuar. Si rezultat, OSHC-të përballen me vështirësi dhe pasiguri për përfshirjen e vullnetarëve në projektet dhe aktivitetet e tyre, duke u ekspozuar ndaj rrezikut të gjobave.

Bashkëpunimi Shtet – OSHC:

Për shkak të mos zbatimit të Udhërrëfyesit Për Hartimin e Politikës dhe Masave Për Një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile i miratuar në 2015, Zyra e Kryeministrit me ndihmën e Delegacionit të BE-së në Shqipëri nisi në vitin 2018 një asistencë teknike 9-mujore drejt një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile. Termat e Referencës për një asistencë të tillë përfshinë përditësimin e Udhërrëfyesit, Planin e Detajuar të Veprimit për periudhën 2018 - 2022, së bashku me kornizën e monitorimit me treguesit dhe buxhetin e kërkuar për zbatimin e tij. Megjithatë, një vit pas këtij procesi, Udhërrëfyesi ende nuk është miratuar nga Qeveria.

Në vitin 2016, u krijua Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile, një organ konsultativ kolegjal që synon të garantojë bashkëpunimin institucional midis shtetit dhe OSHC-ve, në mbështetje të qeverisjes së mirë, demokracisë me pjesëmarrje dhe rritjes së transparencës përmes përfshirjes të shoqërisë civile në këtë proces. Gjatë vitit 2018, performanca e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile ka qenë e dobët sidomos në adresimin e prioritetëve kyçe të OSHC-ve në lidhje me mjedisin mundësues dhe pjesëmarrjen në proceset politikëbërëse.

Me miratimin e Urdhërit nr. 211, datë 20.09.2018⁵ nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, që standartizoi programin e modelit të transparencës dhe e bëri të detyrueshëm për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore në nivel kombëtar, ka disa përmirësime gjatë vitit 2018 rreth nivelit të transparencës

⁴ GZ 92, datë 31/05/2016, Ligji nr. 45/2016. “Për Vullnetarizmin” [Online] <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2016/04/28/45/5e164331-4d77-4a80-abf9-7973591b5d9d;q=Ligji%20nr%2045%2F2016>

⁵ Urdhër Nr. 211, datë 20.09.2018 [Online] http://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/09/Programi_i_Transparences_Pushteti_Vendor.pdf

nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Megjithatë, informacioni i vënë në dispozicion nga institucionet publike (nivel qendror dhe vendor) nuk është gjithmonë i saktë e i plotë dhe shumë herë edhe selektiv. Kjo ndodh më shpesh kur informacioni i kërkuar konsiderohet sensitiv dhe me interes të gjerë publik. Ndodh pjesërisht dhe për shkak të mungesës së burimeve dhe kapaciteteve të institucionit për të përmbushur këto kërkesa.

Sa i përket njoftimit dhe konsultimit publik, Ligjin 146/2014 “Mbi Njoftimin dhe Konsultimin Publik” lejon konsultimet për projektligjet dhe projekt strategjitë. Gjithashtu, në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 828, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e regjistrit elektronik për njoftim dhe konsultim publik”, është krijuar dhe një regjistër elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik <http://www.konsultimipublik.gov.al>.

Gjatë vitit 2018, vërehet një regres mbi konsultimet publike, ku shumica e ligjeve që prekën sektorin u miratuan me një numër të ulët konsultimesh ose pa konsultime. Manuali i Pjesëmarrjes së Publikut në Procesin Vendimmarrës të Kuvendit (i përditësuar)⁶ kufizon të drejtën e qytetarëve dhe grupeve të tjera të interesit për të marrë informacion pa dhënë argumente si dhe parimet e trajtimit të barabartë për të gjithë palët e interesuara për të ushtruar këtë të drejtë.

Regjistri elektronik nuk është i lehtë për përdorim dhe nuk mundëson njoftimin përmes postës elektronike për shtojca apo ndryshime të reja në regjistër.⁷

OSHC-të janë aktorët kryesorë që ofrojnë shërbime cilësore sociale për një gamë të gjerë përfituesish. Sidoqoftë, gjatë vitit 2018, nuk është ndërmarrë apo diskutuar asnjë nismë ligjore mbi ligjin për prokurimet publike që do të lehtësonte pjesëmarrjen e OSHC-ve në proceset e tenderimit publik. Kuadri ligjor dhe rregullator paraqet shumë sfida dhe çështje për t'u adresuar në mënyrë që të krijohet një mjedis mundësues për përfshirjen e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve sociale me fonde publike. Rregullat e tenderimit janë të unifikuara dhe aplikohen në mënyrë të barabartë për OSHC-të dhe ofertuesit e subjekteve të tjera private.

Gjatë vitit 2018 u plotësua paketa ligjore për ndërmarrjet sociale. Megjithatë, ajo është shumë problematike për sektorin, sepse i trajton ndërmarrjet sociale si ndërmarrje shtetërore, kufizon së tepërmi mundësitë e tyre për të aksesuar fonde joqeveritare dhe minimizon hapësirën për produktivitetin e tyre. Regjimi fiskal është shumë kufizues. Të gjithë këta komponentë nuk janë në përputhje me Direktivat e BE-së për ndërmarrjet sociale dhe praktikën evropiane.

⁶ http://parlament.al/Files/Informacione/manuali_i_azhorrnuar_21298_1.pdf

⁷ Matlija, D., Dule, I., “Konsultimi publik në Shqipëri, 2017 – 2018, Ushtrim i çiltër i demokracisë pjesëmarrëse apo thjesht fasadë” [Online] <https://www.puleaks.al/wp-content/uploads/2019/04/Konsultimi-Publik-2017-2018-Res-Publica-NED.pdf>

Gjetjet Kryesore

Nr.	6 gjetjet kryesore të studimit	Referenca në Matricën e Monitorimit		Referenca në Udhëzuesin e BE-së	
		Fusha		Objektivi	
1	Mbeten problem çështjet që lidhen me centralizmin e procesit të regjistrimit të OSHC-ve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe mungesa e të dhënave të unifikuara për sektorin.	Fusha	1	Objektivi	1
		Nën-fusha	1.1	Rezultati	1.1
2	Ligji 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" prezanton kërkesa të reja raportimi për bizneset dhe OSHC-të me vlerë të aseteve dhe/ ose të ardhurave në 30 milionë lekë (rreth 240,000 Euro). Kërkesat kanë rritur barrën dhe ndërhyrjen e shtetit ndaj këtyre OSHC-ve.	Fusha	2	Objektivi	2
		Nën-Fusha	1.1	Rezultati	2.3
3	Transparenca e shpërndarjes së fondeve publike është shumë e ulët dhe mbetet një çështje shqetësuese për sektorin. Përkundër faktit që institucionet publike i kanë rregullat dhe procedurat e transparencës të mirëpërcaktuara, informacioni i bërë publik është i paplotë dhe jo në përputhje me standartin e përcaktuar.	Fusha	2	Objektivi	2
		Nën-Fusha	2.2	Rezultati	2.2
4	Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile ka patur një performancë të dobët gjatë vitit 2018, duke humbur mundësinë për sektorin të angazhohej në një dialog efektiv me Qeverinë me synim zbatimin e reformave të nevojshme.	Fusha	3	Objektivi	3
		Nën-Fusha	3.2	Rezultati	3.1
5	Ka regres mbi konsultimet e kryera nga institucionet publike mbi projektligjet dhe politikat në fuqi.	Fusha	3	Objektivi	3
		Nën-Fusha	3.2	Rezultati	3.1
6	Paketa ligjore për ndërmarrjet sociale u plotësua pas 3 vitesh. Megjithatë, ajo paraqet vështirësi për sektorin, sepse i trajton ndërmarrjet sociale si ndërmarrje shtetërore, kufizon së tepërmi mundësitë e NS-ve për të aksesuar fondet joqeveritare dhe minimizon hapësirën për produktivitetin e tyre. Regjimi fiskal është shumë kufizues. Të gjithë këta komponentë nuk janë në përputhje me Direktivat e BE-së për ndërmarrjet sociale dhe praktikatat evropiane.	Fusha	3	Objektivi	3
		Nën-Fusha	3.3	Rezultati	3.1

Rekomandimet Kryesore:

Nr	6 rekomandimet më të rëndësishme për reformë	Referenca në Matricën e Monitorimit		Referenca në Udhëzuesin e BE-së	
		Fusha		Objektivi	
1	Përgatitja e një kuadri të ri ligjor mbi decentralizimin e procesit të regjistrimit dhe ri-regjistrimit të OSHC-ve.	Fusha	1	Objektivi	1
		Nën-fusha	1.1	Rezultati	1.1
2	Duhet një ndryshim urgjent i Ligjit për "Organizatat Jofitimprurëse", duke sqaruar se çka përbën veprimtari ekonomike dhe se si duhet trajtuar fiskalisht.	Fusha	2	Objektivi	1
		Nën-Fusha	2.2	Rezultati	2.4
3	Rritja e transparencës dhe përmirësimi i procedurave mbi shpërndarjen e fondeve publike për OSHC-të, nga institucionet publike që sigurojnë fonde publike për OSHC-të përmes granteve dhe mekanizmave të tjerë.	Fusha	2	Objektivi	2
		Nën-Fusha	2.3	Rezultati	2.3
4	Përfundimi dhe miratimi i akteve ligjore që rregullojnë vullnetarizmin.	Fusha	3	Objektivi	2
		Nën-Fusha	2.2	Rezultati	2.2
5	Ndryshim i Ligjit "Për Krijimin dhe Funksonimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile". Rritja e efektivitetit të punës së Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile nëpërmjet një bashkëveprimi më të mirë midis anëtarëve të tij dhe OSHC-ve të tjera.	Fusha	3	Objektivi	3
		Nën-Fusha	3.2	Rezultati	3.1
6	Ndryshim i kuadrit ligjor "Për Ndërmarrjet Sociale në Shqipëri" duke përfshirë jo vetëm organizatat jofitimprurëse, por edhe forma të tjera ligjore ekzistuese që funksionojnë sipas parimeve kryesore të sipërmarrjes sociale; Krijimi i mundësive alternative financuese përveç fondit të miratuar për mbështetjen e ndërmarrjeve sociale dhe rishikimin e kushteve kufizuese në lidhje me kriteret ekonomike dhe sociale në lidhje me veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale.	Fusha	3	Objektivi	3
		Nën-Fusha	3.3	Rezultati	3.1

Rreth Matricës

Ky Raport Monitorimi publikohet në baza vjetore që nga viti 2013. Monitorimi bazohet në Matricën e Monitorimit për Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile të zhvilluar nga Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) dhe Qendra Evropiane për Ligjin Jofitimprurës (ECNL). Ai është pjesë e një serie raportesh kombëtare nga 7 vende të Ballkanit Perëndimor dhe Turqi.

Matrica e Monitorimit prezanton parimet dhe standartet kryesore, ekzistenca e të cilave është thelbësore në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet mbështetës dhe mundësues për funksionimin e OSHC-ve. Matrica është e organizuar në tre fusha, secila e ndarë në nënfusha: (1) Garancitë themelore juridike të lirive; (2) Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat financiare të OSHC-ve; (3) Marrëdhënia Qeveri – OSHC.

Parimet, standartet dhe treguesit janë formuluar duke marrë në konsideratë stadin aktual të zhvillimit të sektorit dhe diversitetin në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Ato mbështeten në liritë dhe të drejtat e garantuara ndërkombëtarisht dhe praktikrat më të mira rregullatore në nivelin e Bashkimit Evropian dhe vendeve evropiane. Matrica synon të përcaktojë një situatë optimale të dëshiruar për shoqërinë civile që ajo të funksionojë dhe të zhvillohet në mënyrë efektive dhe synon gjithashtu të vendosë një kuadër realist i cili mund të ndiqet dhe zbatohet nga autoritetet publike. Duke patur parasysh se sfidat kryesore qëndrojnë kryesisht në zbatim, treguesit janë përcaktuar për të monitoruar gjendjen në nivelin e kuadrit ligjor dhe zbatimin praktik të tij.

II. Hyrje

Rreth Raportit të Monitorimit

Partnerët Shqipëri realizoi për të gjashtin vit radhazi studimin për Raportin e Matricës së Monitorimit 2018 (Raporti MM 2018). Ky raport monitorues synon të prezantojë një pasqyrë të çështjeve që lidhen me mjedisin mundësues të OSHC-ve në Shqipëri, duke përfshirë kuadrin ligjor aktual, zbatimin praktik të tij, si dhe të japë rekomandime se si mund të adresohen dhe të trajtohen këto çështje.

Raporti i Matricës së Monitorimit 2018 i përgatitur nga Partnerët Shqipëri bazohet në shqyrtimin e legjislacionit shqiptar, politikave, studimeve dhe raporteve të përdorura për vlerësimin e treguesve ligjorë të Matricës së Monitorimit, si dhe konsultimet me OSHC-të për të vlerësuar treguesit e praktikës së saj.

Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Matrica e Monitorimit paraqet parimet dhe standartet kryesore që janë identifikuar ekzistenca e të cilave është thelbësore në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet mbështetës dhe mundësues për funksionimin e OSHC-ve. Ajo nënvizon faktin se mjedisi mundësues është një koncept kompleks, i cili përfshin fusha të ndryshme dhe varet nga faktorë të ndryshëm, nga faza të zhvillimit të shoqërisë dhe nga sektori i shoqërisë civile.

Matrica është e organizuar në tre fusha, e ndarë secila në nën-fusha:

1. Garancitë Themelore Juridike të Lirive;
2. Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të;
3. Marrëdhënia Qeveri-OSHC.

Kjo Matricë nuk ka për qëllim të mbulojë të gjitha çështjet e mjedisit mundësues, por thekson ato që ekspertët kanë përcaktuar si më të rëndësishme për vendet në të cilat ata kanë kryer veprimtarinë e tyre. Standartet dhe treguesit janë formuluar duke marrë në konsideratë gjendjen aktuale të zhvillimit të sektorit dhe diversitetin në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Ato janë nxjerrë nga përvojat e OSHC-ve në vendet respektive, lidhur me mjedisin ligjor, si dhe praktikën dhe sfidat në zbatimin e tij. Zhvillimi i parimeve, standarteve dhe treguesit është bërë duke pasur parasysh liritë dhe të drejtat e garantuara ndërkombëtarisht dhe praktikën më të mira të Bashkimit Evropian dhe vendeve evropiane.

Fushat janë përcaktuar sipas parimeve kryesore të cilat janë përpunuar më tej në standarte specifike. Për tu dhënë mundësinë OSHC-ve lokale, donatorët ose palët e tjera të interesuara për të rishikuar dhe monitoruar mjedisin ligjor dhe praktikën e zbatimit të tij, standartet shpjegohen më gjërësisht dhe maten nëpërmjet treguesve.

Përpunimi i Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile ishte pjesë e një përpjekjeje të përbashkët të ekspertëve dhe OSHC-ve nga anëtarët dhe partnerët e rrjetit BCSDN dhe me ekspertizë e mbështetje strategjike nga ECNL. Ekipi i ekspertëve prej 11 anëtarësh nga 10 vende të Ballkanit, përfshiu edhe një mori njohurish dhe ekperiencash specifike të OSHC-ve, si ligjore ashtu dhe praktike. Puna me Matricën përfshiu takime pune dhe online nga ekspertët, të cilat u shqyrtuan më pas nëpërmjet fokus grupeve të organizuara me aktorë të ndryshëm dhe konsultimeve publike.

III. Metodologjia

Përmbledhje e përjasjes metodologjike

Për përgatitjen e Raportit të Matricës së Monitorimit 2018, Partnerët Shqipëri përdori një sërë instrumentash metodologjikë, duke përfshirë hulumtim në literaturë, përjasjen me pjesëmarrje në sigurimin e informacionit përmes takimeve konsultuese, intervista me menaxherë të OSHC-ve etj. Qëllimi ishte monitorimi i legjislacionit dhe treguesve të praktikës për të identifikuar progresin ose regresin e mjedisit mundësues duke përfshirë klimën e përgjithshme, legjislacionin dhe zbatimin e tij efektiv për veprimtarinë e OSHC-ve në Shqipëri.

Metodat për përgatitjen e Raportit të Matricës së Monitorimit 2018 janë si më poshtë:

Hulumtim Literature

Duke qënë se Matrica e Monitorimit përmban tregues për vlerësimin e legjislacionit dhe praktikës, hulumtimi i literaturës u realizua përmes:

Rishikimi i Legjislacionit - me qëllim monitorimin e kuadrit ligjor dhe të rregulloreve të hartuara dhe të miratuara në kuadër të këtij monitorimi. Ai përfshin një rishikim dhe analizë të legjislacionit shqiptar (duke përfshirë zbatimin e rregulloreve), si dhe analiza mbi zbatimin e konventave dhe rregulloreve ndërkombëtare të miratuara nga shteti shqiptar.

Rishikimi i praktikës bazuar në të dhënat dytësore, siç janë: raportet e medias; raportet e progresit të përgatitur nga donatorët, organizata ndërkombëtare dhe agjenci kombëtare - me qëllim identifikimin e zbatimit të legjislacionit në praktikë.

Kërkesat zyrtare për informacion nga institucionet publike

Për shkak të mungesës së të dhënave publike nga institucionet shtetërore mbi OSHC-të, Partnerët Shqipëri dërgoi kërkesa zyrtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Parlamentit Shqiptar, Institutit të Statistikave - INSTAT, Administratës Tatimore dhe Ministrisë së Kulturës për të mbledhur të dhëna mbi sektorin, mbi konsultimet publike, mbështetjen financiare dhe jo financiare si dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për sektorin.

Pjesëmarrja e komunitetit të OSHC-ve

Partnerët Shqipëri përdori databazën e saj të të dhënave të OSHC-ve për të informuar dhe ftuar OSHC-të për të marrë pjesë në takimet konsultuese të organizuara për tema të ndryshme që kontribuan në përgatitjen e Raportit të Matricës së Monitorimit 2018.

IV. Gjetje dhe Rekomandime

Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive

Nën-fusha 1.1. Liria e organizimit

Standarti 1: Të gjithë individët dhe personat juridikë mund të themelojnë, t'i bashkangjiten dhe të marrin pjesë lirisht në organizata joformale dhe / ose të regjistruara si offline ashtu dhe online

Liria e organizimit është një e drejtë kushtetuese. Kjo e drejtë garantohet dhe rregullohet përmes kuadrit ligjor dhe ushtrohet lirisht nga individë dhe persona juridikë. Të gjithë individët dhe personat juridikë mund të themelojnë apo të marrin pjesë në organizata të ndryshme, pa diskriminim.

Kuadri ligjor dhe procedurat e regjistrimit/ ri-regjistrimit të OSHC-ve nuk ndryshuan gjatë vitit 2018. Procesi i regjistrimit/ ri-regjistrimit vazhdon të jetë i centralizuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke prezantuar procedura të gjata dhe të kushtueshme për OSHC-të, veçanërisht për ato që ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë Tiranës. Regjistri elektronik për OSHC-të ende nuk është krijuar. Krijimi i një regjistri të integruar me informacione të hollësishme mbi sektorin dhe vënia e tij në dispozicion të publikut, do të kontribuojë jo vetëm me të dhëna të sakta dhe të besueshme për sektorin mbi numrin e OSHC-ve të regjistruara, fushën e aktiviteteve, shpërndarjes gjeografike, numrin e punonjësve me kohë të plotë dhe të pjesshëm, numrin e vullnetarëve, qarkullimi vjetor, burimet e financimit, etj., por gjithashtu do të mundësonte matjen e ndikimit dhe kontributit të sektorit në ekonominë e vendit.

Mungesa e të dhënave publike të unifikuara krijon paqartësi mbi madhësinë e sektorit. Sipas informacioneve zyrtare të marra nga institucionet publike ka të dhëna kontradiktore lidhur me regjistrimin, përbërjen dhe veprimtarinë e OSHC-ve. Sipas informacionit të marrë nga

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në total janë regjistruar **11,426 OSHC**. Vetëm për vitin 2018, janë regjistruar **400 OSHC** të reja, nga të cilat **276 Shoqata**, **45 Fondacione** dhe **79 Qendra**.

Sipas të dhënave të marra nga Instituti i Statistikave (INSTAT)⁸ janë të regjistruara **2,323 OSHC aktive**. Vetëm në 2018 janë **289 OSHC të reja aktive**.

Standarti 2: OSHC-të veprojnë lirisht pa ndërhyrje të pajustificuar të shtetit në qeverisjen dhe aktivitetet e tyre të brendshme.

Kërkesa kryesore e raportimit për OSHC-të mbetet dorëzimi i pasqyrave financiare vjetore në përputhje me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse.⁹

Në maj të 2018 u miratua Ligji për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare¹⁰. Ky ligj paraqet kërkesa të reja raportimi për OSHC-të, nëse shifra e aktivitetit ose e të ardhurave në pasqyrat financiare është në vlerën 30 milionë lekë (përafërsisht 240,000 Euro). Këto OSHC janë të detyruara të publikojnë pasqyrat financiare vjetore në faqet e tyre zyrtare të internetit dhe duhet të përgatitin një raport performance në lidhje me veprimtarinë e tyre, i cili do të publikohet së bashku me pasqyrat financiare vjetore.¹¹ Është e paqartë nëse publikimi i pasqyrave financiare përfshin edhe shënime shpjeguese, që përmbajnë informacione konfidenciale mbi donatorët dhe shpenzimet e OSHC-ve. Formatit i këtij raporti dhe udhëzimi për

⁸ Të dhënat u siguruan përmes një kërkesë për informacion të dërguar nga Partnerët Shqipëri tek INSTAT

⁹ GZ 171/2015 Direktiva nr. 32, datë 17.09.2015 "Për shpalljen e standarteve kombëtare të kontabilitetit për organizatat jofitimprurëse dhe për aplikimin e detyrueshëm" të lëshuar nga Ministria e Financave [Online] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/171-2015.pdf

¹⁰ <http://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/ligj-nr.-25-dt.-10.5.2018.pdf>, Neni 13

¹¹ Idem, neni 22

plotësimin e tij hartohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

Është e rëndësishme të theksohet se raporti i performancës nuk është thjeshtë një raport aktivitetesh, por ka për qëllim të rregullojë matjen e efikasitetit dhe efektivitetit të OSHC-ve, përfshirë koston për njësi (???) të aktivitetit vjetor të tyre. Kjo ngreh shqetësime në lidhje me motivimin dhe nevojën e ligjvënësve për të parashtruar një kërkesë të tillë këtyre organizatave, ku fokusi i veprimtarisë së tyre është mbrojtja e të drejtave të njeriut; monitorimi, vlerësimi dhe denoncimi i rasteve të korrupsionit në të gjitha nivelet e qeverisjes; monitorimi i zgjedhjeve dhe avancimi i kuadrit ligjor në këtë drejtim, etj. Raporti i performancës nuk ka lidhje as me financimin publik që mbështet aktivitetin e OSHC-ve dhe/ose lehtësimet tatimore dhe financiare të ofruara nga shteti. Kjo konsiderohet një shkelje e lirisë dhe pavarësisë së sektorit jofitimprurës.

Formati i raportit të performancës nuk është hartuar ende, por fokusi i përshkruar më sipër i raportit është bërë publik si pjesë e diskutimeve konsultative me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit në përgatitjen e aktit nënligjor.

Gjithashtu, ky ligj parashikon detyrimin që të *“depozitohen për publikim pranë autoritetit përkatës ku janë regjistruar, pasqyrat financiare vjetore...”*. Në rastin e OSHC-ve, “autoriteti përkatës” është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky detyrim është një barrë e shtuar për OSHC-të, veçanërisht për OSHC-të jashtë Tiranës, të cilat do të kenë kosto shtesë për të paraqitur në Gjykatë raportet e tyre financiare dhe dokumentat e tjera që parashikon ligji. Nga ana tjetër, Gjykata nuk ka mandat institucional për të manaxhuar ose përdorur këtë lloj informacioni.

Edhe pse ky ligj parashikon kërkesa të reja për OSHC-të dhe biznesin në përgjithësi, ai u miratua pa konsultime me grupet e interesit. Duke marrë parasysh këtë situatë, është hartuar një deklaratë nga sektori i shoqërisë civile, nismë e Partnerëve Shqipëri, me qëllim evidentimin e sfidave dhe rishikimin e ligjit për një funksionim sa më të mirë të tij. Pas tre muajsh nuk ka ende përgjigje apo reagime nga autoritetet publike mbi dërgimin e kësaj kërkesë.

Bazuar në Ligjin Nr. 65/2016, datë 09.06.2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e

Shqipërisë”¹², ndërmarrjet sociale janë organizata jofitimprurëse, të cilat ushtrojnë veprimtarinë si ndërmarrje sociale pas marrjes së statusit. Udhëzimi Nr. 607, datë 01.08.2018 i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale¹³, përcakton procedurën dhe dokumentacionin që OSHC-të duhet t’i paraqesin Ministrit për të marrë statusin e ndërmarrjes sociale. Sidoqoftë, udhëzimi nuk parashikon të drejtën e ankimit në rastet kur një OSHC i refuzohet statusi nga komisioni i vlerësimit.

Gjithashtu, Ligji për Ndërmarrjet Sociale i jep të drejtën qeverisë vendore për të marrë pjesë në bordin vendimmarrës të ndërmarrjes sociale. Ky kriter, duke përfshirë kushtin lidhur me nivelin e pagës si dhe të drejtën për të marrë statusin dhe ushtrimin e veprimtarisë si ndërmarrje sociale vetëm me financime publike i kthen ndërmarrjet sociale në ndërmarrje të kontrolluara nga shteti. Kjo jo vetëm që e kufizon hapësirën e ndërmarrjeve sociale për të ushtruar veprimtarinë e tyre lirisht, por gjithashtu cënon pavarësinë e tyre nga shteti, pavarësi e siguar nga Ligji për organizatat jofitimprurëse.

Duke iu referuar shpërbërjes së organizatës, Ligji për Organizatat Jofitimprurëse, i ndryshuar¹⁴ dhe Ligji për Procedurat Tatimore, i ndryshuar¹⁵, rregullojnë shpërbërjen apo shpërndarjen e OSHC-ve. Ligji për Procedurat Tatimore parashikon që Gjykata të mos procedojë kërkesën për shpërbërje të parashtruar nga OSHC-të pa konfirmim nga autoritetet tatimore mbi detyrimet e pashlyera. Një nga problemet me këto ndryshime është fakti se ligji, e konsideron përgjegjës përfaqësuesin ligjor të OSHC-së përballë autoriteteve tatimore, për borxhe apo tatime të papaguara, edhe pas shpërbërjes së OSHC-së.

¹² GZ 118/2016, Ligji nr. 65/2016, datë 09/06/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë” [Online] <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2016/06/09/65-201>

¹³ Udhëzimi nr. 607, datë 01.08.2018, “Për procedurat dhe dokumentacionin e kërkuar për njohjen e statusit të ndërmarrjeve sociale ” [Online] <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/01/Udhezim-nr.607-DT-2018/08/01-PER-MARRJEN-E-STATUSIT-TE-NDERMARRJES-SOCIALE.docx>

¹⁴ GZ 36/2013, Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001, mbi “Organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar, Kapitulli VII [Online] https://qbz.gov.al/share/s0AXcHUmTAm53LiuW_wbpQ

¹⁵ GZ Nr. 187, Ligji Nr. 97/2018, datë 3.12.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime të Ligjit për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” [Online] <https://qbz.gov.al/share/dfCkGpG0Qtaj-P4xOxC3xQ>

Bazuar në të dhënat e marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, 140 OSHC janë shpërbërë ose janë në proces likuidimi dhe ç`regjistrimi, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve pohon se janë 176 OSHC të ç`regjistruara. Numri i marrë nga autoritetet tatimore është pak më i lartë, pasi përfshin dhe forma të tjera tek OSHC-të (universitete, kompani private, etj.).

Standarti 3: OSHC-të marrin dhe sigurojnë të ardhura financiare nga burime të ndryshme

brenda dhe jashtë vendit për të mbështetur aktivitetin e tyre.

OSHC-të mund të kërkojnë dhe sigurojnë lirisht të ardhura financiare nga donatorë të ndryshëm vendas dhe të huaj për të mbështetur aktivitetet e tyre pa miratimin e tyre paraprak dhe final nga shteti. **Situata për këtë standart mbetet e njëjtë sikundër është raportuar në raportet e mëparshme të Matricës së Monitorimit.**

Nën-fusha 1.1, reflekton gjithashtu vlerësimin e treguesve të mëposhtëm të **Udhëzimeve të Bashkimit Evropian për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2014-2020**. Gjetjet bazuar në objektivat për secilin tregues janë:

1.1. b. Vlerësimi i cilësisë së legjislacionit ekzistues dhe kornizës politike

- Janë identifikuar të gjitha boshllëqet në legjislacionin kombëtar dhe kornizën e politikës në lidhje me regjistrimin e OSHC-ve.
- Procesi i regjistrimit ende tejkalon periudhën prej 15 ditësh si periudhë maksimale e përcaktuar me ligj.
- Centralizimi i procesit të regjistrimit mbetet sfida kryesore e paraqitur në kuadrin ligjor ekzistues për regjistrimin e OSHC-ve.

1.1. c. Progresi me miratimin dhe zbatimin e legjislacionit relevant

Nuk ka progres mbi adaptimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës në lidhje me regjistrimin, ndërprerjen dhe shpërbërjen e OSHC-ve. Shpërbërja dhe shpërndarja e OSHC-ve rregullohet përmes Ligjit për Organizatat Jofitimprurëse dhe Ligjit për Procedurat Tatimore i ndryshuar në dhjetor 2018. Megjithatë, Ligji për Procedurat Tatimore është i paqartë në lidhje me shpërbërjen.

1.3. a. Cilësia e mjedisit të favorshëm për organizatat bazë

Organizatat me bazë komunitare nuk njihen si një lloj i veçantë OSHC-je në kuadrin ligjor në Shqipëri, ndaj nuk ka politika të veçanta dhe rregulla të aplikuara për këtë lloj organizatash. Mjedisi ekzistues ndikon në mënyrë të barabartë të gjitha OSHC-të.

2.1. b. Vlerësimi cilësor i rregullave financiare (me fokus mbi mekanizmat e ndërtuar që rregullat dhe detyrimet financiare të ndryshojnë me ndryshimin e të ardhurave dhe aktiviteteve joekonomike)

Kërkesa kryesore e raportimit për OSHC-të mbetet dorëzimi i pasqyrave financiare vjetore bazuar në Standartin Kombëtar i Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse, që lehtëson dhe është efikas për OSHC-të e vogla. Ligji 25/2018 mbi Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare paraqet kërkesa të reja raportimi për bizneset dhe OSHC-të me vlerë të aseteve dhe/ ose të ardhurave në 30 milionë lekë (rreth 240,000 Euro). Kërkesat kanë rritur barrën dhe ndërhyrjen e shtetit ndaj OSHC-ve.

Nënfusha 1.2 Liritë e tjera

Standarti 1: Përfaqësuesit e OSHC-ve, individualisht ose nëpërmjet organizatave të tyre, gëzojnë lirinë e tubimit paqësor.

E drejta për të organizuar dhe marrë pjesë në një tubim paqësor është një e drejtë kushtetuese që ka përforcuar të drejtën e njerëzve për t'u organizuar për çdo qëllim legjitim. Në përgjithësi, kuadri ligjor në Shqipëri është në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe e mundëson këtë të drejtë në praktikë. Megjithatë, Ligji Për Tubimet¹⁶ ka nevojë për përmirësim i cili do të sqaronte nevojën për “njoftim” kundrejt “kërkesës”/ “leje”. Ligji duhet të adresojë të drejtën për **kundër-tubime spontane** dhe për **krijimin e formave të njoftimit online** për të mundësuar procedurën e njoftimit nëpërmjet internetit.

Për periudhën 2017- 2018, në bazë të informacionit të dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, shumica e tubimeve janë organizuar në formën e protestave, përkatësisht 284 protesta, ndjekur nga 13 marshime, 4 demonstrata dhe 9 forma të tjera të organizimit.¹⁷

Sa i përket çështjeve, shumica e tubimeve kanë natyrë politike, sociale, ekonomike, kulturore dhe mjedisore dhe shumica e tyre janë organizuar në Tiranë, pasi pjesa më e madhe e institucioneve të rëndësishme publike ndodhen në kryeqytet.

Avokati i Popullit gjatë vitit 2018 ka qenë shumë aktiv, duke dhënë rekomandime ndaj Policisë së Shtetit për të marrë masat e nevojshme për përgatitjen e modeleve standarte për **“Njoftimin e Komisarariatit të Policisë për organizimin e tubimeve në sheshe dhe vendkalime publike”** dhe **“Njoftimin e Komisarariatit të Policisë për organizimin e një tubimi urgjent në sheshe dhe vendkalime publike”** si dhe publikimin e tyre në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për të qenë të aksesueshme për të gjithë qytetarët dhe për të krijuar mundësi për njoftim online në lidhje me organizimin e tubimeve. Një rekomandim tjetër lidhej me

përgatitjen e modeleve standarte, si **“Vendim administrativ për komunikimin me organizatorin ose udhëheqësin e tubimit për ndalimet dhe kufizimet e mundshme apo kushte të tjera, duke përfshirë numrin e personave që do ta ndihmojnë atë”**, në përputhje me Ligjin për Tubimet.

Siç vërehet, një zhvillim pozitiv në lidhje me tubimet është aprovimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të procedurës së brendshme **“Planifikimi i shërbimeve policore gjatë zhvillimit të tubimeve”**. Ky dokument përcakton procedurat standarte për zyrtarët e policisë përpara organizimit të tubimeve, procedurat e përgjithshme për menaxhimin e tubimit dhe shërbimeve të tij, procedurat për ndalimin dhe shpërndarjen e një tubimi si dhe procedura të tjera. Përveç kësaj, dokumenti përfshin anekset e të gjitha modeleve standarte, në përputhje me rekomandimet e zyrës së Avokatit të Popullit. Vendimi ngarkon sektorin përgjegjës për komunikimin me mediat dhe publikun në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë për të vënë në dispozicion dhe për të publikuar modelet në faqen e internetit të Policisë së Shtetit.

Qeveria nuk vendos ndonjë kufizim për përdorimin e mediave sociale, dhe organizatorët/pjesëmarrësit mund ta përdorin atë para, gjatë dhe pas organizimit të tubimit. Mbulimi mediatik përbën një medium të rëndësishëm për të shpallur thirrjet për tubime, për të mobilizuar audiencën dhe mbështetësit.

Standarti 2: Përfaqësuesit e OSHC-ve, individualisht ose nëpërmjet organizatave të tyre gëzojnë lirinë e shprehjes.

Në përgjithësi, kuadri ligjor lidhur me lirinë e shprehjes dhe ndalimi i gjuhës së urrejtjes garantojnë të drejtat e individit në përputhje me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Sidoqoftë, në vitin 2018 pati një përpjekje për paketën anti-shpifje nga Qeveria e Shqipërisë, por u kundërshtua nga organizatat e mediave dhe përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias¹⁸.

¹⁶ GZ 23/2001, Ligji no. 8773, date 23.04.2001 “Për Tubimet” [Online] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2001/PDF-2001/23-2001.pdf

¹⁷ Tavani, K., Këruti, K. Monitorimi i së Drejtës për Tubime Paqësore për 2017 - 2018 në Shqipëri, Partnerët Shqipëri, 2018, fq.7. [Online] http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/02/Albania_Monitoring-assembly-report-2017-2018.pdf

¹⁸ <http://www.tiranaecho.com/latest-news/osce-condemns-albanian-initiative-to-register-all-its-online-new-portals-as-the-anti-defamation-package-sparks-fierce-public-debates/>

Shpifja mbetet një vepër penale, edhe pse dënimet me burg nuk lejohen.¹⁹

Ashtu si edhe në vitet e kaluara, interesat politike, ato të biznesit dhe medias kanë penguar zhvillimin e hapsirave për institucione mediatike të pavarura.²⁰

Në këtë monitorim nuk u raportuan raste nga OSHC-të lidhur me kufizimin e të drejtës së lirisë së shprehjes.

Vlerësimi i Standartit 1 të Nën-Fushës 1.2., pasqyron edhe vlerësimin e treguesve të mëposhtëm të **Udhëzimeve të Bashkimit Evropian për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2014-2020**. Gjetjet për secilin tregues janë:

1.1.b. Vlerësimi i cilësisë së legjislacionit ekzistues dhe kornizës së politikës

- Legjislacioni ekzistues garanton lirinë e organizmit, tubimeve paqësore dhe shprehjes, për të gjithë individët dhe personat juridikë.
- Ligji për Tubimet²¹ ka nevojë për përmirësim i cili do të sqaronte nevojën për “njoftim” kundrejt “kërkesës”/ “leje”. Ligji duhet të adresojë të drejtën për **kundër-tubime spontane dhe krijimin e formave të njoftimit online** për të mundësuar procedurën e njoftimit nëpërmjet internetit.

1.1.c. Progresi me miratimin dhe zbatimin e legjislacionit relevant

- Në vitet e fundit, nuk ka pasur ndryshime në ligjin primar që rregullon lirinë e tubimit në Shqipëri, përkatësisht Ligji nr. 8773, datë 23.4.2001 “Për Tubimet”.
- Ka përmirësime në lidhje me procedurat e brendshme nga autoritetet policore, duke reflektuar nevojat dhe rekomandimet e nxjerra në vitin 2018 nga Avokati i Popullit.

²¹GZ 23/2001, Ligji nr. 8773, datë 23.04.2001 “Për Tubimet” [Online] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2001/PDF-2001/23-2001.pdf

Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të

Nën-Fusha 2.1. Trajtimi tatimor/ fiskal për OSHC-të dhe donatorët e tyre

Standarti 1: Përfitimet tatimore janë të vlefshme për burime të ardhurash të ndryshme të OSHC-ve

Trajtimi fiskal për OSHC-të mbetet problematik dhe paraqet një pengesë të madhe për veprimtarinë, zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e OSHC-ve.

Sipas legjislacionit në fuqi, OSHC-të mund të kryejnë veprimtari ekonomike për të gjeneruar të ardhura në përmbushje të qëllimeve të përcaktuara në statut dhe në aktin e themelimit dhe OSHC-të konsiderohen “person i tatueshëm”. Veprimtaria ekonomike nuk duhet të jetë aktiviteti primar i OSHC-ve (aktiviteti joekonomik duhet të mbizotërojë) dhe të ardhurat vjetore nga veprimtaria ekonomike nuk duhet të kalojnë 20% të të ardhurave vjetore totale. Nëse kjo shumë tejkalon kufirin e regjistrimit të TVSH-së prej 2 milionë lekësh (rreth 15,000 Euro), atëherë OSHC-të, si çdo person tjetër i tatueshëm duhet të regjistrohen dhe të deklarojnë TVSH-në, sipas Ligjit mbi Procedurat Tatimore të vitit 2018.

Tashmë që paketa ligjore e ndërmarrjeve sociale është e plotë, kjo situatë bëhet problematike sepse vetëm OSHC-të kanë të drejtë të aplikojnë për statusin e ndërmarrjeve sociale dhe sipas Ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat

¹⁹ “Paketa e Zgjerimit të BE 2018 - Liria e Shprehjes - Shoqëria e Informacionit dhe Media”, Komisioni Evropian, 2018. [Online] https://euwesternbalkansmediadays.eu/images/FREEDOM_of_EXPRESSION__INFO_SOCIETY_AND_MEDIA_2018.pdf

²⁰ “Liria në Botë 2018 - Demokracia në Krizë”, Freedom House, 2018 [Online] <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/freedom-world-2018>

Jofitimprurëse”²² aktiviteti ekonomik nuk duhet të përbëjë qëllimin parësor të veprimtarisë së organizatës. Përveç kësaj, Ligji për Ndërmarrjet Sociale përcakton që të gjitha fitimet e sektorit duhet të ri-investohen dhe pavarësisht nga paqartësia e ligjit, fitimi do të tatóhet duke zbatuar të njëjtat kërkesa fiskale si për biznesin privat. Këto dy faktorë përbëjnë arsytim të mjaftueshëm për një ndryshim urgjent të ligjit “Për Organizatat Jofitimprurëse”, duke sqaruar se çfarë është aktiviteti ekonomik dhe se si duhet trajtuar në aspektin fiskal. Kjo paketë e re e ndërmarrjeve sociale që zgjati tre vite për t’u plotësuar është kundërshtuar gjerësisht nga sektori ²³, me shqetësimin kryesor që lidhet me trajtimin fiskal të ndërmarrjeve sociale. Partnerët Shqipëri ka publikuar një studim, duke parashtruar një analizë të thellë të paketës ligjore dhe sesi si kjo pengon mjedisin mundësues për SE-të.

Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, janë regjistruar **403 OSHC në skemën e TVSH-së**, që shënon një rënie nga 60% në 20%. Është e paqartë fakti nëse këto OSHC janë ato që marrin pagesë për shërbimet e ofruara si pjesë të aktivitetit të tyre apo kanë mbetur në sistem prej vitit 2015 kur i gjithë sektori raportoi për TVSH-në.

OSHC-të nuk përjashtohen nga TVSH-ja. Aktivitetet e organizuara nga OSHC-të për mallrat dhe shërbimet që lidhen ngushtë me ndihmën dhe kujdesin social; mallrat dhe shërbimet që lidhen ngushtë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve, shërbimet që lidhen me sportin dhe edukimin fizik dhe mallrat dhe shërbimet në fushën e kulturës dhe arsimit janë të përjashtuara nga TVSH-ja.²⁴

Gjithashtu edhe për OSHC-të që ofrojnë shërbime dhe ngarkojnë TVSH, nuk mund të marrin rimbursim si biznesi. Kjo është pothuajse e pamundur pasi ato nuk përmbushin dy kushtet minimale për të kërkuar rimbursim për shkak të karakterit jo të vazhdueshëm të veprimtarisë së OSHC-ve: (1) ka tepriçë debitore të TVSH-

së për tre muaj rrjesht dhe (2) shuma e TVSH-së së kërkuar duhet të kalojë 400,000 lekë (rreth 3,000 Euro). Gjithashtu, e njëjta situatë është edhe me përjashtimin nga TVSH-ja për aktivitetet ekonomike që kryhen nga OSHC-të dhe që konsiderohen si “aktivitete me interes të përgjithshëm” sipas ligjit të TVSH-së. Për të përfutur nga ky përjashtim, OSHC-të duhet të plotësojnë të gjitha kushtet e parashikuara në VKM.²⁵

Edhe kjo përpjekje për të lehtësuar sektorin ka rezultuar e padobishme, pasi procedura është e zgjatuar në kohë dhe nuk zbatohet nga organizatat.²⁶

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve deklaroi se numri i certifikimeve të lëshuara mbi rimbursimin e TVSH-së për projektet e IPA-s nga Delegacioni i Bashkimit Evropian është **11 certifikata**, por mbetet e paqartë nëse ato kanë marrë rimbursim. Deri më sot, nuk ka një konfirmim zyrtar mbi rimbursimin e TVSH-së për projektet e skemës IPA të zbatuara nga OSHC-të.

Duke marrë parasysh ndikimet financiare që përfaqëson TVSH-ja e projekteve të financuara nga Delegacioni i Bashkimit Evropian mbi sektorin, dhe dështimi i të gjitha qeverive për të përmbushur detyrimin e tyre në kuadër të zbatimit të marrëveshjes me Bashkimin Evropian për rimbursim, sektori gjatë vitit 2018 vazhdoi përpjekjet e tij advokuese në këtë drejtim. Me ndihmën e delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri u krijua një **grup pune**, i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë - Drejtoria e Fondit Kombëtar, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së dhe Partnerët Shqipëri si përfaqësuese e sektorit jofitimprurës për të hartuar një procedurë të re rimbursimi mbi TVSH-në. Është hartuar një **draft dokument**, i cili është ende në pritje të miratimit nga Delegacioni i BE-së dhe aprovimit nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Procedura e re pritet të lehtësojë sektorin dhe të përfshijë të gjitha skemat e financimit të BE-së dhe çdo donatori tjetër

²²GZ 28/2001, Ligji nr. 8788, datë 07/05/2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” [Online] <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2001/05/07/8788>

²³Për më shumë informacion mbi Deklaratën e Ndërmarrjeve Sociale shih: <http://partnersalbania.org/News/deklarate-e-ndermarrjeve-sociale-ne-vend-dhe-organizatave-mbeshtetese/>

²⁴Vendimi nr. 953, datë 29.12.2014 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit nr. 92/2014” Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë “i ndryshuar. [Online] <https://www.tatime.gov.al/eng/shkarko.php?id=707>

²⁵GZ. 200, datë 31/12/2014 Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 953, datë 29.12.2014 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit nr. 92/2014 [Online] <https://qbz.gov.al/share/5XhX87R0QRa8AvYakfdPiv>

²⁶Hoxha, J., Topi, A., Tavani, K., “Trajtimi fiskal i OJF-ve - Vlerësimi i Kuadrit Ligjor për Organizatat Jo-Fitimprurëse në Shqipëri dhe Zbatimi i tij në Praktikë” Partnerët Shqipëri, 2018. fq.22 [Online] http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2018/07/Trajtimi_fiskal_i_OJF-ve.pdf

bilateral. Subjekte të rimbursimit të TVSH-së do të jenë gjithashtu edhe skemat e nën-grantimit të zbatuar nga organizatat që luajnë rolin ndërmjetës.

Nuk ka trajtim të diferencuar për OSHC-të mbi taksat vendore, pavarësisht natyrës së tyre jofitimprurëse, misionit, modelit të financimit, mënyrat e funksionimit dhe përfituesit. Në pjesën dërrmuese të njëjta tarifa vendore aplikohen si për OSHC-të, ashtu edhe për bizneset.²⁷ Gjatë konsultimeve me OSHC-të, ata që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Progradec, theksuan se përmes një vendimi të Këshillit Bashkiak²⁸ OSHC-të lokale përjashtohen nga taksa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit.

Gjatë vitit 2018, një zhvillim i rëndësishëm që ndikon në veprimtarinë e OSHC-ve është metodologjia e ndryshuar me të cilën përlogaritet taksa e ndërtesës. Ndërsa llogaritja e mëparshme bazohej mbi sipërfaqen e ndërtesës, që nga prilli i vitit 2018 llogaritja bëhet në bazë të vlerës së ndërtesës dhe norma e tatimit mbi ndërtesën aplikohet si përqindje e bazës tatimore:

- 0.05% për ndërtesat e përdorura për banim nga familjarë
- 0.15% për ndërtesat e përdorura për aktivitet ekonomik

Thënë ndryshe, ky ndryshim paraqet një rritje prej pothuajse dhjetëfish në raport me llogaritjen e mëparshme.

Ndryshimet ndikojnë jo vetëm mbi OSHC-të që kanë në pronësi godinat e tyre, por edhe për ato që i marrin me qera, pasi kjo nënkupton një çmim të rritur të qerasë. Meqenëse ky ligj është miratuar nga parlamenti, nuk ka hapësirë për dialog dhe negociata me qeverinë vendore ku OSHC-të kryejnë aktivitetin e tyre.

Standarti 2: Ofrohen lehtësira për të nxitur dhurimet nga individë dhe korporata

Nuk ka ndryshim të kuadrit ligjor lidhur mbi dhurimet nga individë dhe korporata. Sikundër dhe në raportet e mëparshme, aktiviteti filantropik i individëve dhe kompanive nuk njihet apo rregullohet me ligj të veçantë; prandaj skemat e incentivave fiskale nuk janë të disponueshme. Përmes punës së Partnerëve Shqipëri mbi monitorimin e aktivitetit filantropik të individëve dhe bizneseve, raport i vetëm i këtij lloji i publikuar në vend, gjatë vitit 2018 vërehet një rritje në vlerën 48% të dhurimeve totale krahasuar me vitin e kaluar, me një shumë totale prej 95,182,953 lekësh (përafërsisht 752,000 Euro). Donatorët individualë përbëjnë shumicën e donatorëve që dhurojnë. Fusha kryesore e dhurimeve është Mbështetja e Grupeve të Margjinalizuara. Institucionet publike sociale vazhdojnë të mbetet kanali kryesor për dhurime (46%), ndërsa vetëm 22% e dhurimeve janë kanalizuar përmes OSHC-ve. Duke marrë në konsideratë metodologjinë e limituar, kjo shifër mund të mos përfaqësojë shumën totale të dhurimeve në vend. Si e tillë, krahasimi mund të mos jetë tërësisht i saktë.

Vlerësimi i Standartit 2, i Nën-fushës 2.2., pasqyron edhe vlerësimin e treguesve të mëposhtëm të **Udhëzimeve të Bashkimit Evropian për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2014-2020**. Gjetjet për secilin tregues janë:

2.2. a. Numri dhe lloji i donacioneve për OSHC-të nga donatorë individualë dhe kompani (të specifikuar në vlera monetare)

- Gjatë punës që Partnerët Shqipëri ka kryer mbi monitorimin e aktivitetit filantropik vihet re një rritje prej 48% në vlerën totale të dhurimeve gjatë vitit 2018, kjo krahasuar me një vit më parë, me një dhurim total prej 95,182,953 lekësh (përafërsisht 752,000 Euro). Fusha kryesore e dhurimeve ishte *Mbështetja e Grupeve të Margjinalizuara*. *Institucionet publike* vazhdojnë të jenë kanali kryesor i dhurimeve (46%), ndërsa vetëm 22% e dhurimeve janë kanalizuar përmes OSHC-ve.

²⁷ Idem, fq. 19

²⁸ Vendimi nr. 1, datë 04.01.2019 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Komunën e Pogradecit për vitin 2019" [Online] <http://bashkiapogradec.al/wp-content/uploads/2019/01/output.pdf>

2.2. b. Cilësia dhe zbatueshmëria e zbritjes për dhurimet individuale dhe të korporatave të përcaktuara me legjislacione dhe rregullore

- Ligji për Sponsorizimin është i vetmi ligj që ofron stimuj tatimorë për dhurimet e korporatave. Shuma e sponsorizimit njihet si një shpenzim i zbritshëm nga 3% deri në 5% të fitimit para tatimit.
- Dhurimet nga individët nuk njihen nga ky ligj.
- Kuadri ligjor nuk është favorizues dhe nuk inkurajon dhurimet individuale dhe të korporatave.

2.3. a. Cilësia e sistemit të përfitimeve tatimore për aktivitetet operacionale dhe ekonomike të OSHC-ve

Sistemi i përfitimeve tatimore nuk konsiderohet efektiv për veprimtarinë ekonomike të OSHC-ve.

- Ligji për TVSH-në që hyri në fuqi në vitin 2015, përmbante detyrimin e shtetit për të rimbursuar TVSH-në për të gjitha projektet e financuara nga donatorët, të cilët kanë një klauzolë të tillë në marrëveshjen e tyre dypalëshe me qeverinë shqiptare. Pavarësisht kësaj, procedura për ta bërë rimbursimin më efektiv nuk ndryshoi dhe nuk kishte asnjë projekt të OSHC-ve të rimbursuar gjatë vitit 2018.
- Procedurat e përjashtimit nga TVSH-ja për aktivitetet e klasifikuara si “me interes publik” nuk kanë funksionuar dhe shumë pak OSHC kanë përfituar nga kjo. Procedura është e gjatë dhe jo shumë e qartë, gjë që ka krijuar hezitim në sektor për ta përdorur atë.
- Lidhur me taksat vendore, në përgjithësi nuk ka trajtim të diferencuar për OSHC-të, duke marrë parasysh natyrën e tyre jofitimprurëse, misionin, modelin e financimit, mënyrat e veprimit dhe përfituesit.

Nën-Fusha 2.2 Mbështetja e shtetit

Standarti 1: Financimi publik është i vlefshëm për zhvillimin institucional të OSHC-ve, mbështetjen e projekteve dhe bashkëfinancimin e BE-së dhe granteve të tjera;

Standarti 2: Financimi publik shpërndahet në mënyrë të paracaktuar dhe transparente;

Standarti 3: Kanjë sistem të qartë të llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të financimeve publike.

Financimi publik për veprimtarinë e OSHC-ve është një komponent i rëndësishëm për të siguruar një shoqëri civile aktive dhe të qëndrueshme. Siç është konstatuar edhe në raportet e mëparshme të Matricës së Monitorimit, të dhënat mbi financimin publik të OSHC-ve nuk janë publike dhe informacioni nuk është i lehtë për t'u aksesuar. Ka institucione publike, si Ministria e Kulturës, e cila ofron fonde të konsiderueshme për aktivitetet kulturore por nuk ka dhënë informacion mbi fondet e shpërndara gjatë 2018 sipas kërkesës

së dërguar për informacion. Në këto kushte, mbetet e panjohur madhësia e financimit publik të parashikuar dhe të shpërndarë tek OSHC-të në nivel qendror dhe vendor. Gjatë periudhës së monitorimit, për përgatitjen e këtij raporti Partnerët Shqipëri ka identifikuar disa institucione publike që kanë shpërndarë fonde publike për OSHC-të përgjatë vitit 2018.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC).

Është mekanizmi kryesor në nivel kombëtar për shpërndarjen e fondeve publike tek OSHC-të, me qëllim mbështetjen institucionale të tyre, të projekteve sipas prioriteteve të identifikuar dhe bashkëfinancimin e projekteve të financuara nga BE. Fondi i alokuara nga buxheti i shtetit ndaj Agjencisë për të mbështetur OSHC-të është pothuajse i njëjtë, rreth 101 milionë lekë (përafërsisht 808,000 Euro). Bazuar në të dhënat e publikuara, AMSHC shpall mesatarisht një thirrje të hapur për projekt propozime në vit. Thirrja e hapur për projekt propozime për vitin

2018 u shpall në janar 2018 dhe adresoi pesë prioritete:

1. Kujdesi ndaj mjedisit, duke promovuar nisma ndërgjegjësuere dhe aksione të tjera në drejtimin e mirëmbajtjes ambientale dhe territoriale dhe prioritetet e tjera;
2. Fuqizimi i kapaciteteve rinore në fushën e vullnetarizmit, trajnimeve, sipërmarrjes sociale, turizmit dhe arsimit gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm si dhe protagonizmit në krijimin e organizatave të shoqërisë civile;
3. Mbështetje për shtresat në nevojë dhe grupet e marginalizuara të shoqërisë (jetimët, personat me aftësi të kufizuara, minoritete, LGBTI, etj) nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve të tyre dhe aksioneve të përfshirjes komunitare;
4. Fuqizimi i shtetit të së drejtës, nëpërmjet mbështetjes së iniciativave që kanë në fokus luftën ndaj korupsionit, qytetarinë aktive, rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrjen lokale dhe qendrore si dhe advokacinë për nisma ligjore;
5. Turizmi dhe kultura, si një binom zhvillimi për territorin e Shqipërisë, nëpërmjet iniciativave që kanë si qëllim rritjen e përdorimit të resurseve turistike dhe kulturore, të ndërthurura me protagonizmin rinor dhe atë të shoqërisë civile.

Në total 134 aplikime u dorëzuan në kuadër të thirrjes, ndër të cilat 45 OSHC u shpallën fituese²⁹ me një financim total prej 107.7 milion lekësh (përafërsisht 862,000 Euro). Fondi minimal i mbështetjes ishte 600 mijë lekë (përafërsisht 5,000 Euro), ndërsa fondi maksimale ishte 4.5 milion lekë (përafërsisht 33,600 Euro).

Në lidhje me bashkë - financimin, Agjencia ka mbështetur 22 OSHC nga 86 aplikime të marra, ndërsa mbështetja institucionale është ofruar për 14 OSHC. Thirrja për propozime mbi mbështetjen institucionale nuk u bë publike dhe mungon formati i aplikimit. Mbetet e paqartë se mbi cilat kritere u vlerësuan dhe u shpallën fituesit e mbështetjes institucionale.

²⁹ Kjo e dhënë është siguruar nga AMSHC si përgjigje të kërkesës për informacion të dërguar nga Partnerët Shqipëri.

Një tjetër burim financimi për OSHC-të gjatë vitit 2018 është **Ministria e Kulturës**. Për vitin 2018, Ministria shpalli një thirrje për projekt propozime për individë dhe OSHC-të, fokusuar në fushat e mëposhtme:

- Platforma dhe programe të edukimit përmes artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore;
- Platforma dhe projekte në funksion të turizmit kulturor bregdetar;
- Projekte që mund të integrohen në kuadër të vitit "Skenderbeut";
- Projekte në kuadër të Vitit të Trashëgimisë Kulturore Evropiane;

Sipas Udhëzuesit të thirrjes për projekt propozime, shuma minimale e mbështetjes për projekt propozimet e paraqitura ishte 100,000 lekë (përafërsisht 800 Euro) dhe shuma maksimale 2 milion lekë (përafërsisht 16,000 Euro). Nga të dhënat e publikuara në faqen e internetit të Ministrisë, u dorëzuan në total 291 projekt propozime, prej të cilave 73 u shpallën fituese (individë dhe OSHC).³⁰

Në krahasim me gjetjet e raporteve të mëparshme të Matricës së Monitorimit, vihet re një regres në transparencën e Ministrisë së Kulturës mbi alokimin e fondeve. Udhëzuesi i thirrjes për projekt propozime nuk përmbante informacion mbi buxhetin e përgjithshëm të parashikuar në kuadër të kësaj thirrjeje, ndërsa lista e publikuar mbi fituesit jep informacion mbi titullin e projekteve, vendndodhjeve dhe emrave të fituesve, por jo të buxhetit total të alokuar për projekt.

Fondi i Llotarisë Kombëtare shpalli një thirrje për projekt propozime në vitin 2018. Buxheti total i vënë në dispozicion ishte afërsisht 19,1 milion lekë (përafërsisht 153,000 Euro). Nga të dhënat e publikuara në faqen e internetit të Fondit të Llotarisë Kombëtare³¹ si pjesë e thirrjes u shpallën fitues 2 OSHC. Nuk ka asnjë informacion mbi shumën e mbështetjes financiare të dhënë dhe natyrën e projekteve të financuara.

Transparenca mbi shpërndarjen e fondeve publike është shumë e ulët dhe vazhdon të jetë

³⁰ Informacioni është marrë nga faqja e internetit të Lotaria Kombëtare [Online] <http://lotaria.al/wp-content/uploads/2018/03/Njoftimi-per-Pjesemarrje-Viti-2018.pdf>

³¹ Informacioni është marrë nga faqja e internetit të Fondit të Llotarisë Kombëtare [Online] <http://lotaria.al/wp-content/uploads/2018/03/Njoftimi-per-Pjesemarrje-Viti-2018.pdf>

një çështje shqetësuese për sektorin. Pavarësisht faktit që institucionet publike i kanë rregullat dhe procedurat e transparencës të mirëpërcaktuara, informacioni i bërë publik është jo i plotë.

Në nivel vendor, një zhvillim i rëndësishëm në lidhje me shpërndarjen e fondeve publike për OSHC-të për vitin 2018 ishte shpallja e thirrjes për projekt propozime i **Programit Rajonal për Demokraci Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLoad)**, një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga PNUD. Programi mbështet 12 bashki, (Shkodër, Lezhë, Elbasan, Durrës, Përmet, Korçë, Librazhd, Tropojë, Tiranë, Roskovec, Dibër dhe Prrenjas) nëpërmjet një granti prej 1,130,952 Euro, nga të cilat 80% është kontributi i Programit dhe 20% kontributi i bashkive në një periudhë tre-vjeçare.

Thirrja e parë publike për projekt propozime për OSHC-të u shpall më 8 janar 2018 nga Bashkia e Lezhës dhe u pasua nga bashkitë e tjera. Kjo thirrje targetoi OSHC-të lokale, veçanërisht organizatat me bazë komunitare duke synuar forcimin e kapaciteteve të organizatave të vogla dhe të reja që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këto 12 bashki ³². Sipas informacioneve publike, gjatë thirrjes së parë për projekt propozime u shpallën fituese 30 projekte. ³³

Sikundër dhe skemat e tjera të grantdhënies që targetojnë OSHC-të, evidentohet një mungesë e transparencës pasi nuk ka informacion mbi shumën e alokuar për secilin projekt propozim që është shpallur fitues.

Të gjitha OSHC-të që financohen përmes fondeve publike janë subjekt i Ligjit Nr. 112/2015 “Për Inspektimin Financiar Publik”³⁴ që synon mbrojtjen e interesave financiarë të njësive publike, kundrejt keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit, vjedhjes, shkatërrimit të pronës, shpërdorimit të detyrës apo korrupsionit.

Standarti 4: Ekziston mbështetja jofinanciare nga shteti

Autoritetet shtetërore u sigurojnë OSHC-ve mbështetje jofinanciare si: prona shtetërore, hapësira për qiramarrje pa kompensim financiar (për një kohë të caktuar), trajnime falas, konsultime dhe burime të tjera. Për vitin 2018, Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara deklaroi se u ka ofruar mbështetje jofinanciare OSHC-ve, kryesisht në burime materiale. Gjithashtu, tre prona të konfiskuara i kanë kaluar projektit C.A.U.S.E. për tu përdorur nga OSHC-të për ngritjen e ndërmarrjeve sociale³⁵.

³² Informacioni është marrë nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Shqipëri [Online] http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/projects/poverty_reduction/regional-local-democracy-programme-.html

³³ Informacioni është marrë nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Shqipëri [Online] http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/projects/poverty_reduction/regional-local-democracy-programme-.html

³⁴ Ligji fillimisht u miratua në vitin 2010 pas dekretimit në Parlamentin shqiptar pa ndonjë konsultim me shoqërinë civile. Pas shumë kundërshtimeve dhe rekomandimeve të shumta nga BE-ja (në lidhje me përafrimin e legjislativës si një vend me statusin kandidat për të aderuar në Bashkimin Evropian), u ndryshua vetëm në vitin 2015 duke përfshirë miratimin dhe hyrjen në fuqi të udhëzimeve dhe urdhrave përkatës që mbështesin ligjin:

-Udhëzimi nr.30, datë 27.11.2015 “Për rregullat dhe procedurat për kryerjen e inspektimit financiar publik”;
-Udhëzimi nr. 29, datë 27.11.2015 “Për kriteret për fillimin e inspektimit financiar publik”; Urdhri Nr. 85, datë 09.12.2015 “Për miratimin e Kodit të Etikës për Inspektorët Financiarë Publikë”;
- Urdhri Nr.26, datë 17.02.2016 “Për miratimin e Manualit të Inspektiveve Financiare Publike”.

³⁵ <https://partnersalbania.org/News/fourth-round-of-call-for-proposals-announced-cause-project/>

Vlerësimi i Standartit 2, të Nën-fushës 2.4., reflekton gjithashtu vlerësimin e treguesve të mëposhtëm të **Udhëzimeve të Bashkimit Evropian për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2014-2020**. Gjetjet bazuar në objektivat për secilin tregues janë:

2.4.a. Perceptimi i OSHC-ve në sigurimin e fondeve në aspektet e transparencës, të drejtës dhe jodiskriminimit.

Perceptimi i OSHC-ve mbi transparencën, paanshmërinë dhe shpërndarjen e fondeve publike pa diskriminim nuk është pozitiv. Kjo përforcon gjetjet e vazhdueshme të raporteve të matricave të monitorimit të mëparshme sipas të cilave kriteret e përzgjedhjes nuk janë transparente dhe mbi baza meritash dhe gjatë vendimmarrjes ka ende konflikte interesi, të cilat nuk adresohen.

2.4.c. Cilësia e kuadrit të financimit shtetëror për organizatat e shoqërisë civile (që fokusohet në dokumentin procedural)


Situata me financimin publik, sa i përket buxhetit vjetor të përcaktuar, si dhe rregullave e procedurave për menaxhimin e tij, mbetet e njëjtë. Financimi publik mbetet në nivele të kufizuara, duke arritur të mbështesë vetëm një numër të vogël të OSHC-ve. Ai nuk ka mundur të adresojë nevojat prioritare kyçe të sektorit sepse nuk mbështetet në strategji të mirëplanifikuara dhe afatgjatë.

Nën-Fusha 2.3 Burimet Njerëzore

Standarti 1: OSHC-të trajtohen në mënyrë të barabartë me punëdhënësit e tjerë

Nga informacioni zyrtar i marrë nga Instituti i Statistikave INSTAT ³⁶ janë **8,917 punonjës** të cilët punojnë në **2,323 OSHC**. Mbi bazë prefekturë rezulton se numri më i madh i OSHC-ve aktive ndodhen në Tiranë, siç paraqitet në grafikon e mëposhtëm. Mesatarisht, ka **3.85 punonjës** për secilën OSHC. Punonjësit që punojnë në OSHC përfaqësojnë **0,72%** të numrit total të të punësuarve në Shqipëri. ³⁷

Grafiku nr. 1 Numri i OSHC-ve dhe Punonjësve të ndarë sipas Prefekturave



³⁶ Me kërkesë zyrtare për informacion nga Partnerët Shqipëri për INSTAT

³⁷ Kjo e dhënë është përlogaritur nga Tregu i Punës 2018 [Online] <http://www.instat.gov.al/media/5575/tregu-i-punes-2018-ang-alb.pdf>

Standarti 2: Ekzistojnë politika dhe ligje që mundësojnë vullnetarizmin

Vullnetarët janë një pjesë e rëndësishme e burimeve njerëzore të OSHC-ve. Pothuaj tre vite pas miratimit të Ligjit 45/2016 “Mbi Vullnetarizmin”³⁸, aktet nënligjore që priten të adresojnë regjistrin e vullnetarëve, krijimin e skemave të financimit publik, krijimin e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave mbi aktivitetin vullnetar në vend dhe kodi etik për vullnetarizmin nuk janë hartuar ende.

Si rezultat, OSHC-të ende përballen me vështirësi dhe pasiguri në përfshirjen e vullnetarëve në projektet dhe aktivitetet e tyre, duke u ekspozuar ndaj rrezikut të gjobave. Gjatë konsultimeve me OSHC-të, shumica e OSHC-ve që kanë patur në strukturën e tyre vullnetarë dhe programe vullnetarizmi deklaruan mbylljen e këtyre programeve për shkak të paqartësive dhe frikës nga sanksionet që mund të aplikojnë institucionet publike.

Vlerësimi i Standartit 2, të Nën-fushës 2.3., reflekton gjithashtu vlerësimet e treguesve të mëposhtëm të **Udhëzimeve të Bashkimit Evropian për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2014-2020**. Gjetjet bazuar në objektivat për secilin tregues janë:

1.2.a. Numri i punonjësve në OSHC (të përhershëm dhe me kohë të pjesshme)

Nga informacioni zyrtar i marrë nga Instituti i Statistikave INSTAT janë 8, 917 punonjës që punojnë në OSHC.

1.2. d. Numri i vullnetarëve në OSHC sipas llojit të OSHC-së/vektorit

Nuk ka të dhëna zyrtare mbi numrin e vullnetarëve që angazhohen në OSHC-të.

1.2. f. Cilësia e kuadrit ligjor

Kuadri ligjor që rregullon vullnetarizmin nuk është i plotë dhe mundësues për OSHC-të që punojnë me vullnetarë dhe programe vullnetarizmi, duke u ndeshur me vështirësi dhe paqartësi për përfshirjen e vullnetarëve në projektet dhe aktivitetet e tyre dhe duke i ekspozuar ata ndaj riksut të gjobave.

Fusha 3: Marrëdhënia Shtet – OSHC

Nën-Fusha 3.1 Kuadri Ligjor dhe praktik për bashkëpunim

Standarti 1: Shteti njej, përmes strategjive dhe politikave, rëndësinë e zhvillimit të një bashkëpunimi me sektorin.

Udhërrëfyesi për Hartimin e Politikës dhe Masave për Një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile, i miratuar në vitin 2015, u konsiderua një avancim për sektorin e shoqërisë civile që do të mundësonte bashkëpunimin institucional ndërmjet shtetit dhe OSHC-ve. Udhërrëfyesi përfshiu 55 masa të propozuara që synonin të krijonin një mjedis

mundësues për OSHC-të. Por pas më shumë se 3 vitesh rreth 80% e këtyre masave nuk u zbatuan. Pas një zbatimi kaq të dobët të Udhërrëfyesit, Zyra e Kryeministrit me mbështetjen teknike të ofruar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri nisi në vitin 2018 një asistencë teknike 9-mujore për krijimin e një mjedisi mundësues për zhvillimin e OSHC-ve. Termat e Referencës për një asistencë të tillë përfshinë rishikimin e Udhërrëfyesit, një Plan të Detajuar të Veprimeve për periudhën 2018-2022, me një set treguesish monitorues dhe buxhetin e nevojshëm për zbatimin e tij. Udhërrëfyesi i rishikuar ka në fokus tre drejtime kryesore strategjike dhe nëntë fusha prioritare. Gjatë periudhës qershor – korrik 2018 nisi konsultimi me OSHC-të për dokumentin e rishikuar, duke përdorur dhe regjistrin elektronik për konsultim publik³⁹. Edhe pse një vit pas këtij

³⁸ GZ 92, datë 31/05/2016, Ligji nr. 45/2016. “Për Vullnetarizmin” [Online] <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2016/04/28/45/5e164331-4d77-4a80-abf9-7973591b5d9d;q=Ligji%20nr%2045%2F2016>

³⁹ Informacioni është marrë nga Regjistri Elektronik për Konsultimet Publike [Online] <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/73>

procesi Udhërrëfyesi ende nuk është miratuar nga Qeveria.

Standarti 2: Shteti nje, përmes veprimtarisë së institucioneve të tij, rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimit me të.

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile është një organ konsultativ kolegial që synon të garantojë bashkëpunimin institucional ndërmjet shtetit dhe OSHC-ve, në mbështetje të qeverisjes së mirë, demokracisë dhe rritjes së transparencës përmes pjesëmarrjes dhe përfshirjes së shoqërisë civile në këtë proces. Në përputhje me Ligjin “Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile”⁴⁰, Këshilli përbëhet nga 27 anëtarë, 13 përfaqësues nga institucionet qeveritare, 13 përfaqësues nga OSHC-të dhe 1 përfaqësues nga Këshilli Ekonomik Kombëtar. Në dhjetor 2018, përfundoi mandati i katër anëtarëve nga organizatat e shoqërisë civile. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), duke vepruar si sekretariat, organizoi gjatë janarit 2019 takime konsultative me organizatat e shoqërisë civile mbi kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të rinj. Ende anëtarët e rinj nuk janë zgjedhur edhe pse kanë kaluar gjashtë muaj.

Gjatë vitit 2018, Këshilli organizoi vetëm dy takime, në Mars⁴¹ dhe Qershor⁴², edhe pse ligji përcakton tre takime në vit. Sipas kalendarit të botuar në faqen e internetit të AMSHC-së, takimi i tretë ishte planifikuar të organizohej në nëntor, por nuk u zhvillua.

Konsultimet me OSHC-të tregojnë një performancë të dobët të Këshillit, veçanërisht në adresimin e prioritetëve kyçe të sektorit të OSHC-ve në lidhje me mjedisin mundësues dhe pjesëmarrjen në proceset e krijimit të kuadrit ligjor. OSHC-të ngrenë shqetësimin për mungesën e angazhimit të përfaqësuesve të OSHC-ve në Këshill dhe paaftësinë e tyre për të shprehur në mënyrë të qartë dhe të saktë problematikat dhe kërkesat e sektorit.

Sikundër dhe në Raportin e Matricës së Monitorimit 2017, Ligji për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile duhet të ndryshohet

⁴⁰ GZ 200/2015, Ligji nr.119 / 2015 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile” [Online] <https://qbz.gov.al/share/q9X3GXAjROI2QTN3otTFAA>

⁴¹ dhe ⁴³ Informacioni është marrë nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile [online] <https://drive.google.com/file/d/1i6BMJqH1B0SjuFNjujq4ESUpTxO6jKd/view>

me qëllim që të realizohet përfaqësimi i duhur nga linjat e ministrisë (ndryshimet në portofolet ministrore) dhe numri i përfaqësuesve nga secila ministri (zvogëlimi i numrit të portofoleve ministrore) në mënyrë që të plotësohet balanca e kërkuar e përfaqësimit.

Një strukturë tjetër e rëndësishme, në kuadër të pranimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, është Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian⁴³. Ky është një organ këshillimor për procesin e integritit evropian, që ngrihet pranë Parlamentit, me qëllim nxitjen dhe garantimin e bashkëpunimit gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile si dhe rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integritit. Këshilli përbëhet nga anëtarë të parlamentit, përfaqësues të mediave dhe 6 anëtarë nga organizatat e shoqërisë civile, edhe pse dispozita në fuqi parashikon tre anëtarë.

Gjatë vitit 2018 Këshilli ka organizuar një numër të ulët aktivitetesh edhe si pasojë e klimës së tensionuar politike. Ekziston një mungesë e plotë transparence mbi procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e anëtarëve të OSHC-ve dhe shumë pak hapësirë ju është lënë në dispozicion gjatë këtyre takimeve. Deri më tani, performanca e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian nuk ka arritur të përmbushë rolin e tij si organ këshillimor për çështjet e integritit në BE⁴⁴.

Duke marrë në konsideratë situatën, nevojiten ndryshime të menjëhershme, përfshirë këtu edhe ndryshimin e Ligjit për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Përveç kësaj, nga anëtarët e Këshillit që vijnë nga shoqëria civile pritjet e komunikimit dhe ndërveprimi më i lartë me OSHC-të që ata përfaqësojnë sipas fushave të veprimtarisë. Kjo do të kontribuojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në më shumë koordinim dhe përpjekje strategjike nga sektori në punën me institucionet shtetërore për krijimin e një mjedisi mundësues për funksionimin e OSHC-ve.

Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian duhet të jetë më aktiv, të rrisë transparencën dhe të ofrojë hapësira për diskutime dhe konsultime për çështjet në kuadër të BE-së.

⁴³ Ligji nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian” [online] https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligji_15-2015-1.pdf

⁴⁴ Madhi, G. “Parliament’s Role in The EU Integration Process: In Search of a Genuine Catalyst”, EU Policy Hub [Online] <http://www.eupolicyhub.eu/wp-content/uploads/2019/04/KKIE-brief-en.pdf>

Vlerësimi i nën-fushës 3.1., pasqyron gjithashtu vlerësimin e treguesve të mëposhtëm të **Udhëzimeve të Bashkimit Evropian për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2014-2020**. Gjetjet bazuar në objektivat për secilin tregues janë:

3.1. b. Cilësia e strukturave dhe mekanizmave të vendosura për dialog dhe bashkëpunim midis OSHC-ve dhe institucioneve publike për sa i përket: - Përfaqësimit të OSHC-ve në përgjithësi, - përfaqësimit të OSHC-ve më të vogla / të dobëta, - vizibilitetit dhe disponueshmërisë, - perceptimit të qeverisë për cilësinë e strukturave dhe mekanizmave, - Perceptimi i OSHC-ve mbi strukturat dhe mekanizmat;

- Udhërrëfyesi i rishikuar për hartimin e politikës dhe masave për sigurimin e mjedisit mundësues për shoqërinë civile nuk është aprovuar ende.
- Performanca e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile deri më tani ka qenë e dobët veçanërisht në adresimin e prioriteteve kryesore të sektorit të OSHC-ve në lidhje me mjedisin mundësues dhe pjesëmarrjen në proceset e hartimit të politikave.
- Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian ka kryer pak takime dhe diskutime, dhe Këshilli nuk ka arritur ende të marrë rolin e pritur.

Nën-fusha 3.2. Përfshirja në proceset e politikëbërjes dhe vendim-marrjes

Standarti 1: Ekzistojnë standarte që mundësojnë përfshirjen e OSHC-ve në vendimmarrje, të cilat lejojnë kontributin e OSHC-ve në kohën e duhur.

Më 19 mars 2018, me Vendim të Këshillit të Ministrave⁴⁵, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale iu dha përgjegjësi për të krijuar, mbajtur dhe administruar “Regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit”.

Platforma online pyetshtetin.al administron të gjitha kërkesat për informacion të paraqitur nga qytetarët tek institucionet publike dhe bën publike statusin e kërkesave.

Gjatë vitit 2018 ka patur përmirësime lidhur me transparencën e njësive të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri. Më datë 20.09.2018 Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale publikoi Urdhërin Nr. 211⁴⁶, i cili standartizon programin e modelit të

⁴⁵ GZ 37, date 19.03.2018 PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHPETËRORE “Regjistri elektronik i kërkesave dhe i përgjigjeve për të drejtën e informimit” (Online) <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/03/13/145>

⁴⁶ Urdhri nr. 211, date, http://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/09/Programi_i_Transparences_Pushteti_Vendor.pdf

transparencës dhe e bëjnë të detyrueshëm për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore në nivel kombëtar.

Burime nga raporte të ndryshme raportojnë për një rritje të numrit të kërkesave publike për informacion, duke përfshirë grupet e shoqërisë civile. Gjithashtu, vërehet një rritje në kthimin e përgjigjeve nga institucionet publike ndaj kërkesave për informacion. Është e rëndësishme të theksohet veçanërisht përmirësimet e bëra nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në këtë aspekt.⁴⁷

Gjatë vitit 2018, të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë një faqe zyrtare dhe pothuajse të gjitha kanë publikuar një program transparence dhe një regjistër për pyetje dhe përgjigje⁴⁸. Megjithatë përmbajtja e tyre ka nevojë për përditësim të vazhdueshëm.

Nga të dhënat e Raportit Vjetor 2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, **219 institucione publike** kanë publikuar Programin e Transparencës, **331** kanë caktuar një koordinator për të drejtën e informimit dhe **178** prej tyre kanë publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve⁴⁹,

⁴⁷ IDP (2019), “The 2018 Annual Report”, [Online] http://www.idp.al/wp-content/uploads/2019/03/ENGLISH_Annual_Report_2018_KDIMDP.pdf

⁴⁸ Idem, fq. 10

⁴⁹ Idem, fq. 9

duke shënuar një përmirësim të lehtë krahasuar me Raportin e Matricës së Monitorimit 2017.

Pavarësisht progresit të arritur, ka ende nevojë për përmirësime lidhur me cilësinë e përgjigjeve. Informacioni i dhënë nuk është gjithmonë i saktë, i plotë dhe shpesh herë jepet në mënyrë selektive. Kjo ndodh në rastet kur informacioni konsiderohet sensitiv për publikun e gjerë. Por kjo vjen dhe si rezultat i mungesës së burimeve dhe kapaciteteve të institucionit për të përmbushur këto kërkesa. Vetëm për vitin 2018 janë depozituar **820 ankesa** tek Komisioneri, ndër të cilat **656** të depozituar nga qytetarët dhe **164** nga organizatat e shoqërisë civile⁵⁰. Rritja e numrit të ankesave krahasuar me Raportin e Matricës së Monitorimit 2017 tregon edhe një ndërgjegjësim më të madh të qytetarëve për të drejtat e tyre.

Standarti 2: Të gjitha draft politikat dhe ligjet janë lehtësisht të aksesueshme nga publiku në kohën e duhur.

Përsa i përket njoftimit dhe konsultimit publik, Ligji 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” mundëson kryerjen e konsultimeve mbi draft ligjet dhe projektet strategjike. Ky ligj është konsideruar një ligj përparimtar, por zbatimi i tij, pothuajse në të gjitha aspektet është i dobët.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 828, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave të krijimit dhe administrimit të Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” është krijuar një regjistër elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik <http://www.konsultimipublik.gov.al>.

Gjithashtu, Manuali i Pjesëmarrjes së Publikut në Procesin e Vendimmarrjes së Kuvendit (i përditësuar)⁵¹ është një dokument strategjik që njih rëndësinë nga ana e ligjvënësve të pjesëmarrjes dhe përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Dokumenti i përditësuar është i organizuar në funksion të: informimit, konsultimit, dialogut dhe partneritetit. Megjithatë, në përmbajtje, dokumenti nuk pasqyron qëllimin e tij.

Përsa i përket shprehjes së interesit nga palët e interesuara të publikut për pjesëmarrje në seancat

⁵⁰ Idem, fq. 12-13

⁵¹ http://parlament.al/Files/Informacione/manuali_i_azhornuar_21298_1.pdf

dëgjimore të Komisioneve Parlamentare⁵² ato (palët e interesuara) duhet të paraqesin një kërkesë me shkrim për pjesëmarrje, duke parashtruar qartë arsyet pse kërkohet pjesëmarrja në seancat dëgjimore. Për më tepër, përpiqen të përzgjedhin ato palë të interesuara që arrijnë të shprehin më qartë problematikat e çështjeve të caktuara (???), ose që janë të mirënjohura në aktivitetin që zhvillojnë. Kjo çënon të drejtën e qytetarëve dhe palëve të tjera të interesit për të marrë informacion pa dhënë arsye, dhe parimin e trajtimit të barabartë për të siguruar këtë të drejtë.

Krahasuar me Raportin e Matricës së Monitorimit 2017, vërehet një rritje e informacioneve për konsultime të draft ligjeve nga ministritë, kryesisht Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me 16 konsultime për projektligjet, e ndjekur nga Ministria e Drejtësisë me 12 konsultime dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë me 6 konsultime online. Megjithatë, regjistri elektronik www.konsultimipublik.gov.al nuk është i lehtë në përdorim dhe nuk mundëson njoftimin përmes postës elektronike për ndryshime në regjistër⁵³.

Në nivel vendor, Ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe Ligji 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” detyrojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore që të konsultojë aktet normative me strukturat përfaqësuese të qytetarëve. Por angazhimi i shoqërisë civile është i dobët dhe forumet në dispozicion janë të pakta, veçanërisht në bashkitë e vogla. Nuk ka asnjë njoftim të publikuar nga bashkitë për konsultime publike në regjistrin elektronik <http://www.konsultimipublik.gov.al>.

Standarti 3: Përfaqësuesit e OSHC-ve janë partnerë të barabartë në diskutimet në organet ndërsektoriale dhe zgjidhen përmes kritereve dhe një procesi të mirëcaktuar.

Një tregues tjetër i përfshirjes efektive të OSHC-ve në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse është pjesëmarrja e tyre në organet ndërsektoriale. Qeveria shqiptare është zotuar për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të

⁵² Idem, fq. 20

⁵³ Matlija, D., Dule, I., “Konsultimi publik në Shqipëri, 2017 – 2018, Ushtrim i Cilter i demokracisë pjesëmarrëse apo thjesht fasadë” [Online] <https://www.publeaks.al/wp-content/uploads/2019/04/Konsultimi-Publik-2017-2018-Res-Publica-NED.pdf>

Qëndrueshëm (OZHQ-të). Shoqëria civile është një faktor kyç dhe luan një rol të rëndësishëm në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Në vitin 2018, Qeveria Shqiptare hartoi Raportin Kombëtar Vullnetar të Rishikimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.⁵⁴

Dokumenti nënvizon progresin që Shqipëria ka bërë në zbatimin e OZHQ-ve. Sipas këtij dokumenti, në lidhje me realizimin e OZHQ-ve është ngritur një Komitet Ndërmator, i kryesuar nga Zëvendëskryeministri dhe i përbërë nga institucionet kryesore qeveritare, si dhe aktorë të tjerë nga komuniteti i biznesit, shoqërisë civile dhe akademisë.

Nuk ka një rregullore specifike që parashikon përfshirjen e OSHC-ve dhe që përmban kritere mbi përzgjedhjen e tyre.

Për sa i përket Komitetit Ndërmator nuk ka informacion publik mbi anëtarët që janë pjesë e Komitetit dhe mbi procedurat për përzgjedhjen e këtyre anëtarëve, duke thelluar mungesën e transparencës dhe informacionit mbi punën e bërë deri më tani.

Pavarësisht kësaj, OSHC-të janë pjesë e disa organeve ndërsektoriale, kryesisht e strukturave këshillimore, si Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore etj. Mungesa e kriterëve dhe procedurave të qarta për përfshirjen e OSHC-ve në organet ndërsektoriale, ka rezultuar me pjesëmarrjen e ulët të OSHC-ve në to, mungesë transparence në procesin e përzgjedhjes dhe performancë e dobët të përfaqësuesve të OSHC-ve në këto struktura.

Vlerësimi i nënfushës 3.2., reflekton gjithashtu vlerësimet e treguesve të mëposhtëm të **Udhëzimeve të Bashkimit Evropian për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2014-2020**. Gjetjet bazuar në objektivat për secilin tregues janë:

3.1.a. Përqindja e ligjeve/ akteve nënligjore, strategjive dhe reformave të politikave të konsultuara me OSHC-të në aspektin e: - aksesit të duhur ndaj informacionit; - kohës së mjaftueshme për të komentuar; - përzgjedhjes dhe përfaqësisë / diversitetit të grupeve të punës; - njohjes së kontributit; - shkalla në të cilën informacioni merret në konsideratë; - reagimit/ publikimit të rezultateve të konsultimit

Nuk ka informacion publik mbi këtë tregues. Zbatimi i masës 3.4 të Udhërrëfyesit për Draftimin e Politikave dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Organizatat e Shoqërisë Civile do të mundësonte mbledhjen e të dhënave dhe kryerjen e analizës për këtë tregues.

Nën Fusha 3.3: Bashkëpunimi në Ofrimin e Shërbimeve

Standarti 1: OSHC-të janë të angazhuara në shërbime të ndryshme dhe garojnë për kontrata shtetërore mbi baza të barabarta me ofruesit e tjerë.

Standarti 2: Shteti është angazhuar për financimin e shërbimeve dhe financimi është i parashikueshëm dhe i vlefshëm për periudha afatgjata.

OSHC-të janë aktorët kryesorë që ofrojnë shërbime cilësore sociale për një gamë të gjerë

përfituesish. Sidoqoftë, gjatë vitit 2018, nuk janë ndërmarrë apo diskutuar nisma ligjore mbi ligjin për prokurimin publik. Kuadri ligjor dhe rregullator paraqet shumë sfida dhe çështje për t'u adresuar në mënyrë që të krijohet një mjedis mundësues për përfshirjen e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve sociale me fonde publike.

Rregullat e tenderimit janë të unifikuara dhe aplikohen në mënyrë të barabartë për OSHC-të dhe subjektet e tjera private ofertuese. Kriteri kryesor për fitimin e prokurimit publik është çmimi më i ulët i ofruar, pa marrë parasysh cilësinë e shërbimit. Përveç kësaj, shpenzimet e lidhura me tenderimin dhe kushtet financiare të kontratave (dmth. Fondi i garancisë, rimbursimi i shpenzimeve kundrejt parapagimit, itinerare të rregullta dhe të qarta pagesash) paraqesin

⁵⁴ GoA (2018), "Albania Voluntary Review on Sustainable Development Goals" [Online] https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/20257ALBANIA_VNR_2018_FINAL2.pdf

pengesë serioze për pjesëmarrjen e OSHC-ve në çfarëdo procedurë tenderimi ⁵⁵.

Pas gati dy vite e gjysmë nga miratimi i Ligjit Nr. 65/2016 "Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë"⁵⁶ në vitin 2018 janë miratuar disa akte nënligjore, që plotësojnë paketën e ndërmarrjeve sociale. Vlejnë të përmenden Vendimi Nr. 76/2017 "Për përcaktimin e procedurës mbi inspektimin e aktivitetit të ndërmarrjeve sociale"⁵⁷, Udhëzimi Nr. 602/2018 "Mbi procedurat dhe dokumentacionit e nevojshëm për marrjen e statusit të ndërmarrjeve sociale" ⁵⁸, Vendimi Nr.789 / 2018 "Mbi krijimin e fondit për mbështetjen e ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit të ndërmarrjeve sociale" ⁵⁹, Vendimi Nr. 16/2018 "Për miratimin e listës së veprimtarive të ushtruara nga ndërmarrjet sociale"⁶⁰, Vendimi Nr. 56 / 2018 "Për përcaktimin e kategorive specifike të grupeve të marginalizuara" ⁶¹. Paketa është shumë problematike për sektorin, sepse i trajton ndërmarrjet sociale si ndërmarrje shtetërore, kufizon mundësitë e NS-ve për të përfituar fonde jopublike dhe minimizon hapësirën për produktivitetin e tyre. Regjimi fiskal është kufizues. Të gjithë këto komponentë nuk janë në

⁵⁵ Ligji nr. 9643, datë. 20.11.2006, i ndryshuar me ligjin nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligji nr. 9855, datë 26.12.2007, Ligji nr. 10170, datë. 22.10.2009, Ligji Nr. 10 309, datë 22.07.2010, Ligji nr. 22/2012, Ligji nr. 131/2012 dhe Ligji nr. 182/2014 "PËR PROKURIMIN PUBLIK"

⁵⁶ GZ 118/2016 Ligji Nr. 65/2016 "Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë" datë 9 qershor 2016. http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/118-2016.pdf

⁵⁷ <http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/03/Vendim-Nr.-716-dat%C3%AB-1.12.2017.pdf>

⁵⁸ GZ 20/ 2018 Udhëzimi Nr. 602/2018 "Mbi procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e statusit të ndërmarrjeve sociale", datë 1 gusht 2018. <http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20121/UDHEZIM%20nr.%20602,%20date%201.8.2018.pdf>

⁵⁹ GZ 12/2018, Vendimi Nr. 789/2018 "Për themelimin e fondit për mbështetjen e ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale", datë 26 dhjetor 2018. <http://www.botimezyrtare.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20192/VKM%20nr.%20789,%20date%2026.12.2018.pdf>

⁶⁰ Vendimi nr. 16/2018 "Për miratimin e listës së aktiviteteve të ushtruara nga ndërmarrjet sociale", datë 12 janar 2018. <http://qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%203/VKM%20nr.%2016,%20date%2012.1.2018.pdf>

⁶¹ Vendimi nr. 56/2018 "Për përcaktimin e kategorive të veçanta të grupeve të marginalizuara", të datës 31 janar 2018. <http://qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2015/VKM%20nr.%2056,%20date%2031.1.2018.pdf>

përputhje me Direktivat e BE-së për ndërmarrjet sociale dhe praktikat evropiane.

Në aspektin financiar, në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Sociale, ndërmarrja sociale është e detyruar të përdorë "... fitimin tërësisht për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë së saj", dhe "... duhet të taten për fitimin e realizuar" njësoj si bizneset private me të njëjtin nivel qarkullimi vjetor. Ligji nuk jep hapësirë për ndërmarrjen sociale që të përdorë fitimin e saj në mënyra të ndryshme si: investime, shpërblime, ose rritje pagash për punonjësit. Kjo qasje kufizuese vendos në pikëpyetje vazhdueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve sociale në aspektin e kapaciteteve njerëzore dhe nuk mundëson thithjen e talenteve dhe ekspertizës.

Duke iu referuar financimit shtetëror, Vendimi Nr. 789/ 2018 " Për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale" përcakton krijimin e një fondi prej afërsisht 250 milionë lekësh (rreth 2.1 milion Euro) për periudhën 2019 - 2021. Fondi subvencionon veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale, krijimin e vendeve të reja të punës për grupet e marginalizuara dhe sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe sociale. Megjithatë, vendimi është i paqartë dhe kufizues pasi:

a) Subvencioni do të mbulojë jo më shumë se 70% të kostove të pranuar ose 1,500,000 lekë (rreth 12.000 Euro). Pjesa tjetër do të mbulohet nga subjekti.

b) Subvencioni nuk mund të mbulojë më shumë se 50% të pagës minimale për punonjësit që vijnë nga grupet e marginalizuara.

c) Mbështetja totale financiare nga shteti (duke përfshirë të gjitha format financiare) nuk duhet të tejkalojë shumën prej 14 milionë lekë (rreth 110,000 Euro) për periudhën tre vjeçare.

Nuk ka një proces transparent të aplikimit për të përfituar nga Fondi për SE-të dhe është e paqartë në bazë të cilave kriteret merret vendimi për fituesit.

Duke iu referuar grupeve të marginalizuara, Vendimi Nr. 56/2018 "Për përcaktimin e kategorive specifike të grupeve të pafavorizuara" paraqet 28 kategori të grupeve të marginalizuara. Por

vendiminuk jep qartësimbi kriteret sesivlerësohen këto grupe. Përpos kësaj, disa kategori duken se mbivendosen, ndërsa disa të tjera janë të paqarta.⁶²

Për shkak të kësaj situatë, në dhjetor 2018, u krijua një Task Forcë për të përmirësuar dhe rregulluar mjedisin mundësues të ndërmarrjeve sociale në Shqipëri me përfaqësimin e 20 SE-ve. Task Forca publikoi një deklaratë që adresonte sfidat e paketës ligjore të ndërmarrjeve sociale. Deklarata iu drejtua institucioneve publike përgjegjëse.

Pas katër muajsh nuk ka përgjigje apo reagime nga autoritetet publike për dërgimin e kërkesës. Në përgjithësi, kuadri ligjor dhe rregullator ende paraqet shumë sfida dhe çështje për t'u adresuar në mënyrë që të krijohet një mjedis mundësues për përfshirjen e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve sociale me fonde publike. Korniza ligjore për ndërmarrjet sociale duhet të ndryshohet, duke adresuar pengesat aktuale ligjore dhe nevojat e paraqitura nga ndërmarrjet sociale.

⁶² Informacioni mbi ndërmarrjet sociale është shkëputur nga studimi: <http://partnersalbania.org/publication/analize-e-kuadrit-ligjor-mbi-ndermarrjet-sociale-ne-shqiperi/>



Referenca

- Freedom House, “Liria në Botë 2018 - Demokracia në Krizë”, 2018
[Online] <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/freedom-world-2018G>
- GZ 28/2001, Ligji Nr. 8788, datë 07/05/2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”
[Online] <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2001/05/07/8788>
- GZ 92, datë 31/05/2016, Ligji Nr. 45/2016. “Për Vullnetarizmin”
[Online] <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2016/04/28/45/5e164331-4d77-4a80-abf9-7973591b5d9d;q=Ligji%20nr%2045%2F2016>
- GZ 171/2015 Direktiva Nr. 32, datë 17.09.2015 “Për shpalljen e standarteve kombëtare të kontabilitetit për organizatat jofitimprurëse dhe për aplikimin e detyrueshëm” të lëshuar nga Ministria e Financave
[Online] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare_/2015/PDF-2015/171-2015.pdf
- GZ 118/2016, Ligji Nr. 65/2016, datë 09/06/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”
[Online] <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2016/06/09/65-201>
- GZ 36/2013, Ligji Nr. 8788, datë 07.05.2001, mbi “Organizatat jofitimprurëse”, Kapitulli VII
[Online] https://qbz.gov.al/share/sOAXcHUmTAm53LiuE_wbpQ
- GZ Nr. 187, Ligji Nr. 97/2018, datë 3.12.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime të Ligjit për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”
[Online] <https://qbz.gov.al/share/dfCkGpGOQtaJ-P4xOxC3xQ>
- GZ 23/2001, Ligji no. 8773, date 23.04.2001 “Për Tubimet”
[Online] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2001/PDF-2001/23-2001.pdf
- GZ 23/2001, Ligji Nr. 8773, datë 23.04.2001 “Për Tubimet”
[Online] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2001/PDF-2001/23-2001.pdf
- GZ 28/2001, Ligji Nr. 8788, datë 07/05/2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”
[Online] <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2001/05/07/8788>
- GZ . 200, datë 31/12/2014 Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 953, datë 29.12.2014 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr. 92/2014
[Online] <https://qbz.gov.al/share/5XhX87ROQRa8AvYakfdPiw>.
- GZ 200/2015, Ligji Nr.119 / 2015 “Për Krijimin dhe Funkcionimin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile”
[Online] <https://qbz.gov.al/share/q9X3GXAjROi2QTN3otTFAA>

- GZ 37 , date 19.03.2018 PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE “Regjistri elektronik I kërkesave dhe i përgjigjeve per te drejten e informimit”.
[Online] <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/03/13/145>
- GZ 118/2016 Ligji Nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë” datë 9 qershor 2016.
[Online] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/118-2016.pdf
- GZ 20/ 2018 Udhëzimi Nr. 602/2018 “Mbi procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e statusit të ndërmarrjeve sociale”, datë 1 gusht 2018.
[Online] <http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20121/UDHEZIM%20nr.%20602,%20date%201.8.2018.pdf>
- GZ 12/2018, Vendimi Nr. 789/2018 “Për themelimin e fondit për mbështetjen e ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale», datë 26 dhjetor 2018.
[Online] <http://www.botimezyrtare.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20192/VKM%20nr.%20789,%20date%2026.12.2018.pdf>
- Hoxha, J., Topi, A., Tavani, K ,. “Trajtimi fiskal i OJF-ve - Vlerësimi i Kuadrit Ligjor për Organizatat Jo-Fitimprurëse Në Shqipëri, dhe Zbatimi i Tij në Praktikë” Partnerët Shqipëri, 2018.
[Online] http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2018/06/Paper_on_Fiscal_treatment_of_NPOs_Albania.pdf
- Komisioni Evropian “Paketa e Zgjerimit të BE 2018 - Liria e Shprehjes - Shoqëria e Informacionit dhe Media”, Komisioni Evropian, 2018.
[Online] https://euwesternbalkansmediadays.eu/images/FREEDOM_of_EXPRESSION____INFO_SOCIETY_AND_MEDIA_2018.pdf
- Ligji Nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian”.
[online] https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligji_15-2015-1.pdf
- Ligji Nr. 9643, datë. 20.11.2006, i ndryshuar me ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligji Nr. 9855, datë 26.12.2007, Ligji Nr. 10170, datë. 22.10.2009, Ligji Nr. 10 309, datë 22.07.2010, Ligji Nr. 22/2012, Ligji Nr. 131/2012 dhe Ligji Nr. 182/2014 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”
- Madhi, G. “Parliament’s Role in The EU Integration Process: In Search of a Genuine Catalyst”, EU Policy Hub
[Online] <http://www.eupolicyhub.eu/wp-content/uploads/2019/04/KKIE-brief-en.pdf>
- Matlija, D., Dule, I., “Konsultimi publik në Shqipëri, 2017 – 2018, UShttrim i Cilter i demokracisë pjesëmarrëse apo thjesht fasadë”
[Online] <https://www.publeaks.al/wp-content/uploads/2019/04/Konsultimi-Publik-2017-2018-Res-Publica-NED.pdf>
- Vendimi Nr. 953, datë 29.12.2014 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr. 92/2014” Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë “, i ndryshuar.
[Online] <https://www.tatime.gov.al/eng/shkarko.php?id=707U>
- Vendimi Nr. 1, datë 04.01.2019 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Komunën e Pogradecit për vitin 2019”.
[Online] <http://bashkiapogradec.al/wp-content/uploads/2019/01/output.pdf>

- Vendimi Nr. 16/2018 “Për miratimin e listës së aktiviteteve të ushtruara nga ndërmarrjet sociale”, datë 12 janar 2018
[Online] <http://qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%203/VKM%20nr.%2016,%20date%2012.1.2018.pdf>
- Vendimi Nr. 56/2018 “Për përcaktimin e kategorive të veçanta të grupeve të marxhinalizuara”, të datës 31 janar 2018
[Online] <http://qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2015/VKM%20nr.%2056,%20date%2031.1.2018.pdf>
- Udhëzimi Nr. 607, datë 01.08.2018, “Për procedurat dhe dokumentacionin e kërkuar për njohjen e statusit të ndërmarrjeve sociale“
[Online] <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/01/Udhezim-nr.607-DT-2018/08/01-PER-MARRJEN-E-STATUSIT-TE-NDERMARRJES-SOCIALE.docx>
- Urdhër Nr. 211, date, 20.09.2018
[Online] http://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/09/Programi_Li_Transparences_Pushteti_Vendor.pdf
- Tavani, K., Kërutit, K. Monitorimi i së Drejtës për Tubime Paqësore për 2017 - 2018 në Shqipëri, Partnerët Shqipëri, 2018, fq.7
[Online] http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/02/Albania_Monitoring-assembly-report-2017-2018.pdf
- Qeveria e Shqipërisë (2018), “Albania Voluntary Review on Sustainable Development Goals”
[Online] https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/20257ALBANIA_VNR_2018_FINAL2.pdf

Lidhje të dobishme në internet:

- | | |
|---|---|
| • Kuvendi i Shqipërisë | www.parlament.al |
| • Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile | www.amshc.gov.al |
| • Ministria e Kulturës | www.kultura.gov.al |
| • Llotaria Kombëtare | http://lotaria.al |
| • UNDP Albania | http://www.al.undp.org |
| • Regjistri Elektronik për Konsultimin publik | https://konsultimipublik.gov.al |

RAPORTI PËR SHQIPËRINË
Maj 2018 - Maj 2019